

E DREJTA PARLAMENTARE DHE POLITIKAT LIGJORE

2002

Në këtë numër:

Opinione për Politikat Ligjore

- Akte që synojnë forcimin e kontrollit financiar në sektorin publik

E Drejta Kushtetuese dhe reforma zgjedhore

- Çështje të rishikimit dhe qëndrueshmërisë së Kushtetutës
- Sistemet zgjedhore në Europë
- Diskutim për zgjedhjen e sistemit zgjedhor

Disa reflektime mbi integrimin europjan

10

Botim i Qendrës së Studimeve
Parlamentare

PËRMBAJTJA E REVISTËS:

Numri X, viti 2002

Faqe

Opinione mbi politikat ligjore:

Akte që synojnë forcimin e kontrollit financiar në sektorin publik	Luan SHAHOLLARI	4
--	-----------------	---

E Drejta Kushtetuese dhe reforma zgjedhore

Çështje të rishikimit dhe të qëndrueshmërisë së Kushtetutës	Aurela ANASTASI	11
Sistemet zgjedhore në Europë	Jozefina TOPALLI	23
Diskutim për zgjedhjen e sistemit zgjedhor	Ilirian CELIBASHI	29
Koha për propocionalin	Henri ÇILI	34

Integrimi europjan

Disa reflektime për integrimin europian	Eno NGJELA	42
---	------------	----

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Filip LAKO	50
------------	----

Përmbledhje në anglisht:

Disa reflektime mbi integrimin europjan	64
Informacion mbi legjislacionin e miratuar	72

TABLE OF CONTENTS

10th Issue, year 2002

	Page
Opinions about legal policies	
Legislative initiatives that aim at the strengthening of the financial control in the public sector	
Luan SHAHOLLARI	4
The Constitutional Right and the electing reform	
Issues about the reviewing and sustainability of the Constitution	
Aurela ANASTASI	11
Electing systems in Europe	
Jozefina TOPALLI	23
Discussion on the selection of the electing system	
Ilirian CELIBASHI	29
Time for the proportional	
Henri ÇILI	34
European Integration	
Some reflections on the European Integration	
Eno NGJELA	42
Information on Laws passed by the Assembly	
Filip LAKO	50
Summary in English:	
Some reflections on the European Integration	64
Information on Laws passed by the Assembly	72

Rubrikat në vijim synojnë prezantimin e politikave ligjore dhe trajtimeve teorike për organizmin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve të studjuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanëshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.

Forcimi i kontrollit financiar në sektorin publik përbën një nga prioritetet e reformës institucionale të qeverisë dhe kërkesë e domosdoshme për angazhimet politike të saj. Për këtë qëllim, në këtë numër janë zgjedhur për t'u trajtuar iniciativat legjislative për kontrollin e brendshëm financiar në institucionet publike.

Në rubrikën “E Drejta Kushtetuese dhe reforma zgjedhore” paraqiten disa opinione mbi probleme të veçanta të kësaj reforme. Diskutimi i reformës zgjedhore, për vetë rëndësinë thelbësore që ka në zhvillimet demokratike, kërkon angazhimin jo vetëm të aktorëve politikë, por dhe të ekspertëve dhe profesionistëve të kësaj fushe. Për këtë qëllim nëpërmjet përzgjedhjes së kësaj çështjeje synojmë të japim një kontribut në zgjedhjen e alternativave përkatëse.

Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.

Akte që synojnë forcimin e kontrollit financiar në sektorin publik

Mendime për projektligjin “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik dhe “Për kontrollin e brendshëm në sektorin publik”

*Luan Shahollari
Zëvendësministër i Financave*

I. DOMOSDOSHMERIA DHE QËLLIMI

Prej vitit 1991 e këtej është bërë një punë e madhe sasiore dhe cilësore për implementimin e një legjislacioni që sanksionon sistemin e pluralizmit politik dhe të ekonomisë së tregut, përfshirë këtu Kushtetutën dhe një varg aktesh të tjera ligjore për zbatim të saj. Një vend të rëndësishëm zënë ligjet që kanë dalë për të rregulluar veprimtari të caktuara të fushës ekonomike, financiare dhe të kontrollit. Megjithatë, procesi i hartimit të ligjeve të reja dhe i rinovimit të atyre ekzistuese do të jetë i vazhdueshëm. Kjo diktohet jo vetëm nga domosdoshmëria për të plotësuar mangësitë e deritanishme, por edhe nga detyrat e reja që dalin tani pas vendimit të Këshillit të Ministrave të BE-së për hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit me vendin tonë. Pra, shumë është bërë, por ndoshta më shumë mbetet për të bërë në të ardhmen.

Në këtë kuadër, nuk mund të konsiderohet normale që të ecim në të tashmen ose të ardhmen me ligje të mbartura nga sistemi i kaluar, mbetur si rudimente të tij, që nuk janë efektive për sistemin e sotëm. Në rastin konkret e kemi fjalën për ligjin nr.6942 datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare“, i cili përbën ende një objekt veprimtarie për administratën publike, përfshirë këtu organet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe ato të kontrollit të brendshëm. Përveç

ligjeve “të demoduara” kemi edhe një zbrazëti ligjore në fushën e kontrollit të brendshëm në sektorin publik, pasi prej dy-tre vjetësh organet përkatëse të tij e mbështesin veprimtarinë e tyre mbi një vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo zbrazëti mendoj se duhej mbushur vite më parë, ndoshta që në fillim të tranzicionit, pasi parandalimi dhe ndëshkimi i shkeljeve ligjore dhe lufta efektive kundër korrupsionit në administratën publike, ka qenë dhe mbetet objektiv parësor i shtetit ligjor në një sistem demokratik.

Kam mendimin se këto mangësi kanë ardhur për shkak të nënvleftësimit që i është bërë rolit të kontrollit të brendshëm në parandalimin e zbulimin e shkeljeve ligjore në fushën e administrimit të vlerave materiale dhe monetare dhe të mbivlerësimit, në krahasim me to, të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Dihet se ky i fundit funksionon mbi bazën e detyrave të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligjin organik të tij dhe, për rrjedhojë, nuk mund të shtrihet në morinë e problemeve që dalin gjatë veprimtarive të përditshme të institucioneve qendrore ose vendore, si dhe shumëllojshmërinë e rregullave dhe udhëzimeve që nxjerrin ministrinë, institucionet qendrore dhe ndërmarrjet ose institucionet në varësi të tyre. Nënvleftësimi i rolit të kontrollit të brendshëm ka arritur deri aty sa ka institucione qendrore dhe njësi të varura prej tyre që ende nuk kanë ngritur struktura të veçanta të kontrollit të brendshëm. Kjo është një nga arsyt kryesore që vërehen shkelje, të cilat në pamje të parë duken të vogla, por në tërësinë e tyre përbëjnë vlera të konsiderueshme materiale dhe monetare.

Insitucionet e specializuara ndërkombëtare, që drejtojnë fusha të tilla si SIGMA (organ i BE-së dhe OECD-së), si dhe Banka Botërore, gjithashtu, kanë tërhequr vëmendjen për mbushjen e zbrazëtisë ligjore, nëpërmjet hartimit të ligjeve tona sipas standardeve ndërkombëtare.

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr.217, datë 5.5.2000 “Për kontrollin financiar”, Ministria e Financave është ngarkuar për hartimin e projektligjit “Për auditimin e brendshëm”, si dhe për rishikimin e ligjit të lartpërmendur. Mirëpo, duhet theksuar se hartimi i ligjeve sa më funksionale në kushtet e

vendit nuk është një detyrë e lehtë, si për shkak të mungesës së përvojës së brendshme, ashtu dhe për shkak të shumëllojshmërisë së përvojave që na sugjerohen nga institucionet ndërkombëtare. Kjo duket edhe në praktikën e hartimit të dy ligjeve të mësipërme. Fillimisht u hartua një projekt nga grupi i punës në Ministrinë e Financave me specialistë edhe nga dikasteret e tjera, i konceptuar si një ligj integral për auditimin dhe kontrollin e brendshëm në sektorin publik. Por Banka Botërore në raportin “Për vlerësimin e përgjegjshmërisë financiare” të majit 2002, rekomandon që projektligji “Për auditimin e brendshëm” të jetë i vecantë.

Kështu u hartua projektligji “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i cili tani është në proces shqyrtimi në komisionet e Kuvendit, si dhe “Për kontrollin e brendshëm në sektorin publik”, i cili synon të shfuqizojë ligjin “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”. Madje, dilemat, nëse duhen ose jo dy ligje, vazhdojnë. Ka mendime që ligji për kontrollin e brendshëm në sektorin publik të zëvendësohet me ato që quhen “Letër politikat” (Policy paper), praktika që ende nuk kanë hyrë në veprimtarinë e administratës sonë publike. Në këtë shkrim po trajtojmë rastin kur mund të dalin dy ligje, përderisa Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi ende nuk janë shprehur ndryshe.

II. KU AFROHEN DY PROJEKTLIGJET

Dy projektligjet e lartpërmendura i afron qëllimi dhe objekti përafërsisht i njëjtë, të cilat synojnë rritjen e efektivitetit të kontrollit financiar në tërësi. Qëllimi i tyre është të përcaktojnë parimet, rregullat, përgjegjësitë, objektivat, fushën e veprimtarisë, organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm dhe të kontrollit të brendshëm në sektorin publik. Të dy projektligjet e ushtrojnë veprimtarinë tyre në sektorin publik, me të cilin nënkuptohen ministrinë dhe institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave ose të ministrive, organet e pushtetit vendor dhe subjekte publike në varësi të tyre, shoqëritë tregtare me kapital tërësisht shtetëror ose ato ku pjesëmarrja e shtetit në kapitalin e

tyre është mbi 50 përqind, bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e sigurimeve dhe institucionet financiare, ku pjesëmarrja e kapitalit shtetëror në to është mbi 50 përqind. Dihet tashmë se kontrolli në sektorin privat është rregulluar nga akte ligjore të tjera.

Projektligjet i afrojnë parimet e përbashkëta të veprimtarisë, siç janë ai i ligjshmërisë, që do të thotë se veprimtaria e tyre duhet t'i nënshtrohet Kushtetutës dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe i standardeve që parashikon përparësinë e respektimit të standardeve ndërkombëtare dhe marrëveshjeve të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë në hartimin e ligjeve që rregullojnë fushën e veprimtarisë të auditimit dhe të kontrollit të brendshëm.

Auditimi i brendshëm si pjesë e sistemit të kontrollit të brendshëm ka një lidhje të ngushtë me të, pasi rekomandimet dhe vlerësimet e tij shërbejnë si bazë për të bërë përmirësimet e nevojshme në procedurat dhe rregullat, të përcaktuara si detyrim ligjor i subjekteve publike.

Objekti i tyre i përbashkët është rritja e efektivitetit të auditimit dhe përsosja e rregullave të kontrollit, për të parandaluar ose zbuluar shkeljet ligjore në fushën ekonomike dhe financiare, si dhe për të luftuar shfaqjet e korrupsionit, që sipas sondazheve të kryera nga organizma të pavarur ndërkombëtarë janë mjaft të përhapura në administratën publike, me pasoja negative jo vetëm në ekonomi, por në shoqërinë shqiptare në tërësi. Këto rregulla synojnë ruajtjen dhe përdorimin e burimeve financiare, materiale e njerëzore dhe rritjen e frytshmërisë tyre.

Projektligjet përcaktojnë Këshillin e Ministrave si organin qendror që vendos për çështjet më kryesore për rregullimin e veprimtarisë së auditimit dhe të kontrollit të brendshëm, pasi ky organ është administratori i pronës publike, kurse përgjegjësitë e institucioneve të tjera janë përshkallëzuar sipas niveleve dhe rëndësisë, nga ato qendrore deri tek subjektet publike në varësi të tyre.

Ato përcaktojnë, gjithashtu, Ministrinë e Financave si dikasterin, që krahas akteve nënligjore që nxjerr vetë i propozon Këshillit të Ministrave për aktet

që janë në kompetencë të tij. Në strukturën e saj parashikohet të bëjnë pjesë Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Brendshëm, si dhe Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm, të cilat janë përgjegjëse për hartimin dhe verifikimin e rregullave metodologjike të njësuara për njësitë e ngritura në dikastere dhe institucione qendrore.

Po kështu, në të dy ligjet përcaktohen edhe përgjegjësitë e organeve të qeverisjes vendore për auditimin dhe kontrollin e brendshëm në sektorin publik, duke mbajtur parasysh vecoritë e funksionimit të tyre, si organe të pavarura.

III. VEÇORITË QË I DALLOJNË DY PROJEKTLIGJET

Para se të flasim për vecoritë që i dallojnë dy projektligjet, duhet të sqarojmë termat “auditim” dhe “kontroll”. Termi i parë, i shprehur në anglisht, pasi nuk po gjendet një term i përshtatshëm në shqip, nënkupton kontrollin, të cilin e përdorim në praktikën tonë, kurse termi i dytë në anglisht “control” nënkupton administrimin. Pra, titulli i projektligjit për kontrollin e brendshëm në sektorin publik, në ndryshim nga konceptet e deritanishme (kontrolli baraz auditim), është emërtuar në përshtatje me standardet dhe terminologjinë ndërkombëtare.

Kështu, “auditimi i brendshëm” nënkupton një veprimtari të pavarur, në bazë të së cilës vlerësohet nëse përgjegjësitë e drejtimit janë realizuar apo jo. Ai raporton shmangiet dhe sugjeron përmirësime të veprimeve të subjektit publik, duke përdorur mënyrën me të mirë për vlerësimin dhe përmirësimin e frytshmërisë të sistemeve të kontrollit të brendshëm që mbulojnë kontrollet financiare dhe kontrole të tjera drejtimi.

Kurse “kontrolli i brendshëm” nënkupton mënyrën e organizimit dhe metodat e përdorura, për të ndihmuar dhe siguruar drejtuesit se programet e tyre po arrijnë rezultatet e parashikuara, se burimet e përdorura për të realizuar këto programe janë në përputhje me qëllimet dhe objektivat e subjektit publik dhe se ato janë të siguruar nga mashtrimet, keqpërdorimet, pasi të

dhëna reale e të besueshme janë përfituar dhe përdorur për vendimmarrjen. Parimi kryesor mbi të cilën është ndërtuar projektligji është se kontrolli i brendshëm shpreh përgjegjësinë e administrimit.

Auditët e brendshëm janë profesionistë, të punësuar në auditimin e brendshëm të sektorit publik dhe të kualifikuar sipas kërkesave të përcaktuara në ligj. Në projektligjin për auditimin parashikohet edhe ngritja e një Komiteti të Auditimit të Brendshëm, i përbërë nga 7 anëtarë, që përcaktohen nga Ministri i Financave, me përzgjedhje në bazë të disa kriterëve të caktuara, kurse në rastin e kontrollit nuk lind një nevojë e tillë. Të drejtat dhe kushtet e pranimit në punë të auditëve, gjithashtu, janë më të përcaktuara se ato të kontrollorëve. Konfliktet e interesave për auditin më tepër u përkasin rregullave të zgjedhjes së individëve, kurse në rastin e kontrollit synojnë ndarjen e përgjegjësisë të urdhëruesve me ekzekutuesit e urdhrave apo udhëzimeve.

Auditimi i brendshëm parashikon ngritjen e njësisë të përhershme dhe të veçanta nga të tjerat, kurse kontrolli i brendshëm, me përjashtim të Ministrisë së Financave, nuk parashikon njësi të tilla, por, në varësi me kushtet dhe mundësitë, mund të specializohen punonjës brenda strukturave ekzistuese.

Kontrolli i brendshëm në sektorin publik synon që, me anë të ndërtimit të sistemeve, hartimit dhe zbatimit të rregullave dhe procedurave, të sigurojë në mënyrë të vazhdueshme organet drejtuese të subjektit publik se drejtimi ecën sipas objektivave të caktuar dhe se burimet përdoren në mënyrë të frytshme. Përveç parimeve të përgjithshme si ligjshmëria dhe standardet, në projektligj përcaktohen edhe parime të veçanta të kontrollit, mbi bazën e të cilit do të hartohen aktet nënligjore përkatës dhe manualët e procedurave, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Monitorimi është i lidhur edhe me burimet e tjera të kontrollit të brendshëm, siç janë ligjet për Buxhetin e Shtetit, për kontabilitetin, për thesarin etj.

Kontrolli paraprak, i përfshirë në projektligj, nënkupton sistemin e nënshkrimit të dyfishtë dhe kontrollin e thesarit dhe përbën hallkën më të

rëndësishme për parandalimin e shkeljeve dhe të parregullsive ose minimizimin e efekteve tyre. Në një kre të veçantë janë përcaktuar edhe kërkesat për tipet e tjera të kontrollit, si kontrolli i vlerësimit të drejtimit dhe ai pas kryerjes veprimeve. Përcaktimi i konfliktit të interesave, për rregullat që parashikohet të dalin në zbatim të ligjit, është një faktor parandalues për shkeljet dhe parregullsitë.

Projektligji për kontrollin e brendshëm në sektorin publik përbën një hap të rëndësishëm në administrimin më të mirë të burimeve financiare, materiale e njerëzore në subjektet e sektorit publik dhe synon të rrisë në një shkallë më të lartë frytshmërinë e përdorimit tyre.

Ndërsa projektligji për auditimin synon të mbush një zbrazëti ligjore, ai për kontrollin e brendshëm synon të shfuqizojë ligjin e vitit 1984, por edhe të plotësojë ndonjë mangësi, që është krijuar për zbatimin e përgjegjësisë materiale dhe financiare. Kodi Civil, si dhe Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, megjithëse janë rishikuar vitet e fundit, përsëri lënë shtigje për interpretime të ndryshme në vlerësimin e përgjegjësisë materiale, pasi nuk kanë përcaktime e kritere unike për përgjegjësinë financiare.

Më në fund, duke mos u shkëputur plotësisht nga dilema që përmenda më lart, duke qënë të afërt nga qëllimi, objekti dhe objektivat, ekziston risku i dublimit të funksioneve. Megjithatë, zbrazëtia ligjore duhet të plotësohet dhe ligji i vjetër duhet të zëvendësohet me një të ri. Pas kësaj mbetet të organizohet monitorimi për shkallën e dublimit dhe rrugët e zvogëlimit të saj. Sidoqoftë mbetet i padyshimtë fakti se këto akte ligjore do të forcojnë kontrollin financiar në sektorin publik.

Çështje të rishikimit dhe të qëndrueshmërisë së Kushtetutës

*Prof.As. Aurela Anastasi
Pedagoge e të Drejtës Kushtetuese
Kryetare e Shoqatës së Konstitucionalistëve Shqiptarë*

1. Vështrim i përgjithshëm doktrinar.

Ardhja e kushtetutave moderne në botë u shoqërua me konceptet e rëndësishme të epërsisë dhe qëndrueshmërisë, të cilat ishin frymëzuar nga idetë që u paraprin revolucioneve borgjeze. Të dyja këto bënin të mundur kufizimin e pushtetit të mbretit në atë kohë dhe vendosjen e kushtetutshmërisë në shoqëri. Kjo do të thoshte pranim i epërsisë së Kushtetutës mbi normat e tjera nga pikëpamja politike e juridike dhe respektim i saj si një normë e shenjtë. “*Meqenëse mishëron miratimin e një shumice të gjerë të trupit shoqëror, kushtetuta sjell një legjitimitet të lartë, si një mit i shenjtëruar*”¹. Jo pa qëllim i gjithë mendimi shoqëror u drejtua nga epërsia e kushtetutës, duke e vënë atë në krye të sistemit hierarkik të normave dhe duke e shndërruar parimin e kushtetutshmërisë në strumbullarin e të gjithë sistemit politik. Epërsia e saj është shumë e rëndësishme për të krijuar struktura shtetërore të qëndrueshme. Kjo epërsi dhe “shenjtëri” e mban kushtetutën jashtë zhvillimeve të politikës së zakonshme, duke sjellë qëndrueshmërinë e sistemit demokratik, pasi ajo bën që disa struktura

¹ Oliver Duhamel, Yves Mény, “Dictionnaire constitutionnel”, Presses Universitaires de France, 1992, fq. 213

themelore të shtetit të qëndrojnë mbi politikat zgjedhore dhe të sigurojnë paprekshmërinë e sistemit shtetëror, pavarësisht nga rezultatet e zgjedhjeve ose nga forcat politike që fitojnë zgjedhjet.

Nga pikëpamja politike, kushtetutshmëria identifikon kushtetutën me një pakt të madh social. Ky kuptim, si dhe epërsia e kushtetutës kanë formuar edhe një nga arsyet kryesore të debatit mbi ndryshueshmërinë e kushtetutës, debat ky që e ka shoqëruar gjithë historinë e kushtetutave. “Çdo kushtetutë bazohet ose mbështetet në një vendim ose kompromis themelor, prandaj ajo nuk mund të vihet në pikëpyetje përmes procedurave që synojnë ndryshimin e saj”, shkruante Karl Schmidt, një nga autorët më në zë të jurisprudencës gjermane në tridhjetë vitet e parë të shekullit XX². Madje, ky debat shpuri në hartimin e kushtetutave që quhen të ngurta, për shkak se nuk parashikonin fare ndryshimin e tyre ose parashikonin një procedurë mjaft të vështirë për kryerjen e shtojcave. Sidoqoftë, Kushtetuta e Spanjës e 1912-ës dhe ato greke të 1911-ës e të 1952-it kanë qenë të vetmet kushtetuta që shprehimisht ndalonin ndryshimin e tyre. Kjo, sepse zëri i kundërt ishte i njëkohshëm dhe shpejt u kthye në mbizotërues: kushtetutat nuk janë të pandryshueshme. “...Demokracia nga vetë natyra e saj është relative, prandaj shumica ka të drejtë të bëjë ndryshime të çfarëdollojshme për të cilat bie dakord”, shkruante Hans Kelzeni, ky shpikës i madh në fushën e ligjeve e të normave³. Kështu, kushtetutat që e ndalonin ndryshimin e tyre mbetën një numër i vogël në raport me ato që e parashikonin shprehimisht atë.

Jeta evoluon dhe vazhdimisht shtron probleme të reja. Kështu, një kushtetutë e pandryshueshme nuk do të mund të përballojë dot zgjidhjen e tyre. Ajo do të kishte një jetë të shkurtër. Pra, është jetëgjatësia e saj ajo që

² Shih: Xhezair Zaganjori “Demokracia dhe shteti i së Drejtës”, Shtëpia Botuese “Luarasi”, Tiranë, 2002, fq.63

³ Cituar nga Xhezair Zaganjori, vep.përm., fq.63

sjell nevojën e ndryshimit, me qëllim që të përshtatet me realitetet e reja të cilat nuk mund t’i parashikoheshin gjatë procesit të hartimit. Gjithashtu, nevojën e ndryshimit të kushtetutave e sollti edhe formalizmi i tyre. “*Një kushtetutë, në qoftë se do të ishte krejtësisht e ngurtë, nuk do të ishte një kushtetutë formale, pasi nuk do të ekzistonte asnjë formë e prodhimit të këtij tipi norme, ndërkohë që një kushtetutë që modifikohet po aq lehtësisht sa edhe ligji nuk do të ishte e tillë*”⁴. Sot është bërë e qartë në të gjitha kushtetutat se ato janë të rishikueshme në pjesë të tyre të veçanta. Të rishikosh një kushtetutë do të thotë të modifikosh përmbajtjen e saj, duke përshtatur një ligj kushtetues sipas dispozitave të parashikuara nga vetë kushtetuta në fuqi. Tradicionalisht, doktrina dallon kushtetutat elastike, për të cilat rishikimi është relativisht i lehtë, dhe kushtetutat e forta për të cilat procesi i rishikimit është një proces i vështirë. Por ideja bazë mbetet po ajo: “*...Një kushtetutë duhet të na japë garanci për një jetë të gjatë dhe qëndrueshmëri dhe ajo nuk mund të modifikohet sipas dëshirës së shumicës politike. Rishikimi duhet të jetë i rrethuar nga maturia e kujdesi për të nënvizuar aspektin themelor të paktit kushtetues*”⁵. Kjo është arsyeja që kushtetutëvënësit janë përpjekur të zbatojnë një procedurë më të ndërlikuar dhe të vendosin kufizime absolute për ndryshimin e kushtetutës. Si kushtetutat e forta, edhe ato më elastiket (më të butat), të cilat ndryshojnë relativisht nga njëra-tjetra, kanë përpunuar rregulla e kritere për të ndërlikuar procesin e rishikimit të kushtetutës, me qëllim që ajo të mos bëhet objekt i ndryshimeve të shpeshta e të shpejta për shkak të oportunitetit politik. Nëse do të vendosnim krah njëra-tjetrës qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e kushtetutës nga njëra anë, dhe ndryshueshmërinë e saj në krahuin tjetër, do të thonim se ndryshueshmëria është në funksion të qëndrueshmërisë.

⁴ Shih: Louis Favoreu, etc “Droit Constitutionnel”, Édition Dalloz 1998, fq. 132

⁵ Oliver Duhamel, Yves Mény, “Dictionnaire constitutionnel”, vep.përm. fq. 213

2. Kushtet e mjetet e veçanta që vendosen për rishikimin e kushtetutës.

Në të gjitha kushtetutat demokratike janë vendosur kushte, mjete, afate dhe teknika të veçanta të rishikimit. Shkalla e vështirësisë që ndiqet për rishikimin e kushtetutave, në raport me ligjet e tjera, lidhet drejtpërdrejt me qëndrueshmërinë e demokracisë. Kjo vështirësi i përgjigjet tekniko-juridikisht konsensusit politik të një shumice të gjerë midis pozitës e opozitës për ndryshimin e kushtetutës, konsensus që praktikisht duhet të jetë më i gjerë se sa ai për miratimin e ligjeve të tjera. Teknika e rishikimit të kushtetutës nuk është gjë tjetër veçse një përcaktim i procedurës ligjvënëse nëpërmjet përforcimit të kushteve të vlefshmërisë së saj. Çdo element i procedurës ligjvënëse duhet të jetë i përforcuar në këtë rast, me qëllim që të bëjë të detyrueshme marrëveshjen e një shumice shumë të gjerë.

Asnjë kushtetutë nuk shprehet për rishikimin tërësor të saj, por lejon vetëm atë të pjesëve të veçanta. Kjo është e natyrshme dhe i shërben sërish raportit që anon nga jetëgjatësia dhe qëndrueshmëria e kushtetutës. Madje, shkohet edhe më tej. Kushtetutat e sotme kujdesen që të paraqesin shprehimisht edhe ato pjesë të vetes së tyre që janë të pandryshueshme. *“Kur flitet për rishikim të kushtetutës, nënkuptohet ruajtja e bërthamës esenciale të kushtetutës së modifikuar, pra të asaj pjese që disa e quajnë si “superkushtetutë”⁶”*. Kështu vendosen disa kufizime që konsiderohen si *kufizime absolute për rishikimin* e kushtetutës. Shpesh këto kufizime janë të shprehura nga vetë kushtetuta, por mund të jenë edhe të pashprehura, siç ndodh në Kushtetutën aktuale shqiptare. Kufizimet absolute përbëjnë parimet e përgjithshme që qëndrojnë në bazë të rendit juridik, dispozitat që sanksionojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, dispozitat që përcaktojnë formën e qeverisjes etj. Mjaft kushtetuta i sanksionojnë shprehimisht këto kufizime. P.sh., ndalime të tilla bëhen shprehimisht në disa

⁶ Giuseppe De Vergottini “Diritto Costituzionale Comparato”, Padova, 1999, fq. 206

kushtetuta të pas Luftës II Botërore (Kushtetuta e Francës, e Italisë, e Gjermanisë, e Greqisë etj.) P.sh., në nenin 110 të Kushtetutës greke theksohet se dispozitat e Kushtetutës mund të jenë objekt rishikimi, me përjashtim të atyre që përcaktojnë bazën dhe formën e regjimit politik si republikë parlamentare etj.⁷

Në Kushtetutën e Shqipërisë nuk kanë zënë vend në ndonjë nen të posaçëm të saj, drejtpërdrejt të shprehura, kufizimet absolute të rishikimit. Por kjo nuk do të thotë se ajo nuk vendos kufij të rishikimit. Asnjë kushtetutë nuk përmban rregulla për rishikimin e gjithë trupit të saj e, për rrjedhojë, nuk lejon rishikimin e normave që përbëjnë thelbin. Megjithatë, në përmbajtjen e Kushtetutës Shqiptare nuk është e vështirë të vëmë re se kufizimet e rangut absolut ekzistojnë, edhe pse të pashprehura drejtpërdrejt. Parimet që përbëjnë bazën e këtij shteti dhe bazën e qeverisjes (parime të sanksionuara në pjesën e parë të saj) ose të drejtat dhe liritë themelore të Njeriut që “*qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik*” (neni 15), nuk mund t’i nënshtrohen ndryshimeve kushtetuese. Nuk mund të zëvendësohet parimi i sovranitetit të popullit, i ndarjes së pushteteve, parimi i pluralizmit etj., ndryshimi i të cilave do të sillte ndryshime në vetë thelbin dhe në përmbajtjen demokratike të shtetit. Kështu, asnjë lloj maxhorance, qoftë edhe e gjerë, nuk do të ishte legjitime për të sjellë ndryshime të tilla. Kjo del edhe duke ndjekur frymën e përgjithshme kushtetuese dhe traditën kushtetuese, të forcuar tashmë në të gjitha shtetet demokratike. Ruajtja e kësaj fryme e tradite është mjaft e rëndësishme. Ndonjëherë ajo është edhe më e fortë se vetë neni që ndalon shprehimisht ndryshimin e pjesëve të caktuara të kushtetutës. Përndryshe, politikanët nuk e kanë asnjëherë të vështirë t’i japin formalisht një pamje në dukje të ligjshme ndryshimeve kushtetuese. Në histori ka shembuj që dëshmojnë se edhe kur kufizimet e rishikimit kanë ekzistuar shprehimisht në

⁷ Shih Kushtetuta e Greqisë, përkthim në shqip, në përmbledhjen “Kushtetuta”, Shtëpia Botuese Albin, Tiranë, 1995

kushtetutë, për shkak të paqëndrueshmërisë e të oportunitetit politik, është arritur të kapërcehen këto kufizime. I tillë është rasti më i njohur shqiptar i rënies së Statutit të vitit 1925 i cili sanksiononte në Shqipëri republikën dhe i zëvendësimit të tij me Statutin Themeltar të Mbretërisë Shqiptare (1928).

Në Statutin Themeltar të Republikës Shqiptare (1925) theksohej shprehimisht se *“forma republikane e shtetit nuk mund të ndërrohet në asnjë mënyrë”* (Art. 141). Kjo dispozitë u bë pengesë për rishikimin e kësaj Kushtetute më 1928, pasi ishte shfaqur hapur ambicja e Presidentit të atëhershëm të Republikës, Ahmet Zogut, për t’u shpallur mbret. Ndodhi që e gjithë nisma për rishikimin e kushtetutës në disa pjesë të saj, të përfundonte në lëvizje për rishikimin total dhe për hartimin e një kushtetute të re. Parlamenti ekzistues u shpërnda dhe u shpallën zgjedhje të reja për Asambleenë Kushtetuese, e cila hartoi Statutin Themeltar të Mbretërisë Shqiptare⁸.

⁸ E gjithë përpjekja për rishikimin e Statutit filloi me mbledhjen e Senatit të datës 14 maj të vitit 1928, në të cilën u theksua se në Statutin e Republikës është i nevojshëm shtimi i një dispozite për Këshillin e Shtetit. Ky propozim iu dërgua Dhomës së Deputetëve dhe u kërkuar të bëhej mbledhja e përgjithshme e të dyja dhomave, pra e Asamblesë Legjislativë, në bazë të artikullit 141 të Statutit. Por, Dhoma e Deputetëve, e mbledhur një javë më vonë në 21 maj, bashkë me këtë propozim shqyrtoi edhe mocionin e paraqitur nga 44 deputetë të saj për një rishikim të përgjithshëm të Statutit. Fillimisht, Senati nuk iu përgjigj Dhomës së Deputetëve. Dukej qartë se ideja e Dhomës së Deputetëve hasi në kundërshtime. E indinjuar, kjo i dërgoi një apel Presidentit të Republikës, në të cilin theksohej se Senati, në dëm të shtetit, kërkon të ruajë të metat e Statutit, duke heshtur për revizionimin e tij, prandaj i kërkonte Presidentit të dekretonte mbledhjen e Asamblesë për t’i dhënë fund çështjes së parashtruar. Në mbështetje të këtij apeli të paraqitur nga Kryesia e Dhomës, Ahmet Zogu, vetëm pak ditë më pas, në 28 maj, u drejtoi të dyja Dhomat të Parlamentit një mesazh me të cilin, në bazë të artikujve 79, 28 e 141 të Statutit, urdhëronte një sesion të jashtëzakonshëm qysh të nesërmen e përfundimit të sesionit të zakonshëm. Ky sesion do të bisedonte për rishikimin e Statutit, pasi ai ishte i metë në mjaft drejtime dhe nuk parashikonte ndër të tjera organe shtetërore shumë të rëndësishme si Kryeministri, Këshilli i Shtetit etj. Mesazhi i Presidentit u pranua nga të dyja Dhomat në mbledhjen e tyre të përbashkët të 6 qershorit.

Afatet. Zgjatja e afateve për rishikimin e kushtetutës është një teknikë shumë e përdorur, sidomos në periudhat e para të kushtetutshmërisë moderne. Ideja është po ajo që, një kushtetutë formale nuk mund të modifikohet me dëshirën e një shumice parlamentare, që është krijuar përkohësisht. Vendimi për rishikimin e kushtetutës duhet të reflektohet gjatë dhe të merret nga një shumicë e gjerë e formuar nga përfaqësues të popullit në periudha të ndryshme. Kjo teknikë është tashmë në fuqi në disa shtete demokratike. Ajo bazohet në parimin e sovranitetit të popullit dhe në idenë se një brez nuk mund t’i imponojë ligjet e veta brezit pasardhës. P.sh. në Hollandë, ndiqet procedura e mëposhtme: *publikimi i një projekti të rishikimit të votuar nga Parlamenti, pastaj shpërndarja e dy dhomave të parlamentit, shtetet e përgjithshme. Dhomat e reja miratojnë rishikimin me një shumicë prej dy të tretat e votave.* Në Belgjikë dhe në Danimarkë mjafton një propozim për rishikimin e kushtetutës, që të shpërndajë parlamentet e shteteve.

Filluan bisedimet lidhur me propozimin e Senatit për ndryshimin e Statutit. Tashmë ishte bërë e qartë se në të vërtetë, nuk ishte më fjala për një ndryshim të zakonshëm, i cili mund të kryhej me lehtësi edhe në bazë të artikullit 141 të Statutit, por për një ndryshim themelor. Ish-republikanët heshtën. Rezistenca që bënë pak deputetë (sidomos deputetë të zonës së Vlorës e të Himarës, të cilët me synimet e tyre për një autonomi të brendshme vendore nuk kishin interes për fuqizimin e pushtetit të Ahmet Zogut), ishte gati e papërfillshme. Në fund, të dyja dhomat vendosën të pranonin “propozimin e Senatit” për ndryshimin e Statutit duke miratuar këtë shtojcë në artikullin 141 të tij: “Rishikimi i përgjithshëm i Statutit i përket Asamblesë Kushtetuese. Kur vendoset nevoja e rishikimit të përgjithshëm të Statutit, sipas procedurës së caktueme në këtë nen, të dy dhomat quhen vetiu të shpërndame dhe dekretohen zgjedhje për Asamblenë Kushtetuese, simbas nenit 47 të Statutit”. Mbledhja, në bazë të kësaj shtojce, vendosi menjëherë shpërndarjen e të dyja dhomave. Qysh të nesërmen, Presidenti Ahmet Zogu, që po jetonte ditët e fundit të tij në këtë detyrë, dekretoi zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese, të cilat do të zhvilloheshin në 17 gusht të atij viti në bazë të ligjit të zgjedhjeve në fuqi.

Më gjerë shih: Aurela Anastasi, “Institucionet politike dhe e drejta kushtetuese në Shqipëri 1912-1939”, Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë, 1998, fq. 119-129.

Shpallen menjëherë zgjedhje të reja dhe dhomat e parlamenteve miratojnë propozimet për rishikimin e kushtetutës sipas kushteve përkatëse: në Belgjikë kuorumi i nevojshëm për çdo dhomë është 2/3 dhe pranohet me shumicë 2/3; në Danimarkë kërkohet vota e parlamentit dhe një referendum pas gjashtë muajsh. Kështu, këto kushtetuta të forta kanë përpunuar afate dhe kushte që krijojnë vështirësi, me qëllim që ndryshimet të jenë të menduara mirë.

Procedurat e përforcuara dhe të veçanta të rishikimit. Kushtetutat parashikojnë procedura të përforcuara për rishikimin. Kjo shprehet në të gjitha etapat e ndjekura për përshtatjen e një rishikimi: në kushtet që vendosen për të iniciuar rishikimin (nisma për rishikimin e kushtetutës nuk është e njëjtë me nismën ligjvënëse); në kuorumin e domosdoshëm që kërkohet për të shqyrtuar një projekt rishikimi, i cili nuk është i barabartë me atë që kërkohet për shqyrtimin e ligjeve të zakonshme; në shumicën e cilësuar që kërkohet në rastet e rishikimit, shumicë jo e barabartë me atë të ligjeve të zakonshme; në nënshtrimin e rishikimit të zbatuar nga parlamenti ndaj referendumit popullor, çka nuk bëhet për ligjet e zakonshme etj. Këto kritere i ka ndjekur edhe Kushtetuta Shqiptare për procesin e rishikimit të saj (neni 177)⁹.

⁹ Procedura e veçantë për rishikimin e Kushtetutës në bazë të Kushtetutës shqiptare:

Procedura e Ligjet për rishikimin e Kushtetutës Ligjet e tjera ndjekur

iniciativa	jo më pak se 1/5 e anëtarëve të Kuvendit	Këshilli i ministrave, çdo deputet,
miratimi i projektit për rishikim	2/3 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit ose me referendum kur e kërkon 2/3 e Kuvendit	20,000 zgjedhës shumica absolute ose shumica e cilësuar me 3/5
shpallja e ligjit	Presidenti i Republikës nuk ka të drejtë ta kthejë për rishqyrtim ligjin e miratuar nga Kuvendi për rishikimin e Kushtetutës.	Presidenti i Republikës shpall ligjin e miratuar brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij. Ai ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.
Hyrja në fuqi e ligjit	Ligji i miratuar me referendum shpallet nga Presidenti i Republikës dhe hyn në fuqi datën e parashikuar në këtë ligj.	Ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren zyrtare

Duke ndjekur këto procedura, padyshim që mund të arrijmë në përfundime të drejta për klasifikimin e kushtetutave në kushtetuta të forta dhe elastike. Më poshtë janë renditur fazat kryesore të procedurave që ndiqen në disa nga shtetet demokratike për rishikimin e kushtetutës. Kështu, është e mundur të njihemi me to dhe të nxjerrim konkluzionet e dëshiruara.

Francë 1958 (art.89): Përshtatja e një teksti identik nga Asambleja Kombëtare dhe Senati. Paraqitja e këtij teksti nga Presidenti i Republikës Referendumit ose Kongresit të Parlamentit (mbledhjes së të dyja dhomave), në rastin e një projekti të rishikimit (jo të një propozimi). Përshtatja nga Kongresi bëhet me shumicë prej tri të pestash.

Gjermani: Votim nga Bundestagu dhe Bundesrati me shumicë prej dy të tretash të çdo dhome.

Shtetet e Bashkuara: Votimi i amendamenteve kushtetuese me shumicë prej dy të tretash të Dhomës së Përfaqësuesve dhe të Senatit ose thirrja e një konvente *ad hoc* me kërkesë të dy të tretave të shteteve. Nevoja për ratifikim paraqitet nga legjislaturat me tri të katërtat e Shteteve ose nga konventat në tre të katërtat e tyre.

Britania e Madhe: Për shkak të mosekzistencës së një kushtetute në kuptimin formal të fjalës nuk ekziston as edhe një procedurë rishikimi. Në *Parliament acts* të viteve 1911 e 1949 u përshtat sipas procedurës ligjvënëse të zakonshme. P.sh., afati maksimal pesëvjeçar i Parlamentit Britanik u përcaktua nga *Parliament act* i vitit 1911. Por në qoftë se një Parlament në fund të afatit vendos të mos mbahen zgjedhje të përgjithshme, nuk ka ndonjë pengesë ligjore që ai të mos e shfuqizojë ligjin e vitit 1911¹⁰. Sidoqoftë, është tradita kushtetuese ajo që ruan qëndrueshmërinë e Kushtetutës në Angli.

Greqi: Nevoja e rishikimit miratohet nga Dhoma e Deputetëve me shumicë prej tri të pestash të anëtarëve, me dy votime të ndara, me një afat

¹⁰ Shih: “Fjalor përmbledhës i Politikës”, (Oxford), përkthyer në shqip e botuar nga Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, Tiranë, 2001, Zëri, Kushtetutë.

minimal prej një muaji. Dhoma në vijim prononcohet mbi themelin e rishikimit me shumicë absolute të anëtarëve të saj. Ka një afat minimal prej pesë vjetësh midis dy rishikimeve.

Itali: Miratimi i rishikimit nga dy Dhomat, pas dy vendimeve të mëparshme me një afat minimal prej tre muajsh. Për një votë të dytë është i nevojshëm një votim me shumicën absolute të anëtarëve që përbëjnë çdo Dhomë. Mundësia, në një afat tremujor, e një kërkesë për një referendum kushtetues. Ky referendum nuk bëhet i mundur nëse në çdo Dhomë rishikimi ka fituar me shumicë prej dy të tretat e anëtarëve.

Shqipëri: (neni 177) Nisma për rishikimin e Kushtetutës mund të ndërmerret nga jo më pak se një e pesta e anëtarëve të Kuvendit. Miratimi i projektit të paraqitur kryhet me një shumicë prej dy të tretat e anëtarëve të Kuvendit, i cili në raste të caktuara mund të vendosë nëse ligji për rishikimin e Kushtetutës do t'i nënshtrohet referendumit ose jo.

Bullgari: Të drejtën e nismës e ka një e katërta e deputetëve dhe Presidenti. Kuvendi Popullor e miraton ligjin për ndryshimin e Kushtetutës me shumicë prej tri të katërtash të të gjithë anëtarëve të Kuvendit Popullor, me tri votime të kryera në ditë të ndryshme.

3. Kushtetutë e fortë apo e butë?

Kështu, mund të arrijmë në përfundimin se mund të renditen si kushtetuta të forta ato të SHBA-së, Belgjikës, Danimarkës, Hollandës, ndërsa Kushtetuta shqiptare mund të hyjë në kushtetutat që relativisht janë më të buta, e ndjekur nga Kushtetuta gjermane ose ajo bullgare. Megjithatë, të gjitha ruajnë njëfarë fortësie. “Duke u nisur nga përparësitë teorike të kushtetutës së fortë, sot në botë dominon kushtetuta e fortë. Megjithatë, ka edhe teoricienë të cilët edhe sot konsiderojnë se kushtetuta e butë është më fleksibël edhe më e përshtatshme për vende të caktuara, sidomos ato të tranzicionit. Natyrisht, ka argumente të fuqishme në të mirë të njëjës apo tjetrës formë të kushtetutës. Mirëpo, anojnë ato në të mirë të kushtetutës së fortë.”¹¹

¹¹ Kurtesh Saliu “E Drejta Kushtetuese”, Libri I, Prishtinë, 1998, fq.54.

Është e natyrshme që dikush të ketë mendimin se kushtetuta të tilla do të ishin më të përshtatshme në demokracitë e konsoliduara dhe jo në vendet që aktualisht po kalojnë në fazën e tranzicionit. Megjithatë, përvoja ka treguar se në këto të fundit është e nevojshme që t’i mëshohet më tepër respektimit të kushtetutës, plotësisht të kuadrit ligjor për zbatimin e saj, dhe jo ndryshimit të shpeshtë të saj. E themi këtë sepse: *së pari*, kushtetutat e vendeve në tranzicion janë relativisht të reja dhe të mbështetura fuqimisht në traditat e arritjet demokratike botërore. Ato kanë pasur mundësi të vjelin dhe të sanksionojnë në kushtetutë institutet më të reja të kushtetutshmërisë botërore. Pra, përgjithësisht, nuk ka ende institute të tejkaluara në to. *Së dyti*, në këto vende ka mjaft nevojë, që klasa politike dhe të gjitha subjektet në shtet të pajisen me kulturën e duhur kushtetuese, me qëllim që të bëhen të ndërgjegjshme për respektimin e saj. Mungesa e kulturës së kushtetutshmërisë çon shpesh në mosrespektimin e kushtetutës. P.sh., në praktikën shqiptare mund të gjenden disa shembuj që dëshmojnë shkeljen e afateve dhe detyrimeve të parashikuara në Kushtetutë. I tillë është rasti i mosrespektimit nga Kuvendi, i afatit tre vjeçar nga hyrja në fuqi e Kushtetutës për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute. I tillë ishte edhe rasti i mosrespektimit nga Kuvendi i detyrimit kushtetues për të shqyrtuar dekretet e Presidentit të Republikës për emërimin e ministrave. *Së treti*, për shkak të paqëndrueshmërisë politike, që karakterizojnë vendet në tranzicion, shpesh kushtetuta bëhet objekt i ndryshimeve, për t’i shërbyer oportunitetit politik. Madje ajo edhe mund të rrezikojë të shkelet për hir të oportunitetit politik. Për shembull, gabimisht, nga disa qarqe të politikës shqiptare u shtrua nevoja për ndryshimin e dispozitave të Kushtetutës që rregullojnë Kontrollin e Lartë të Shtetit, pasi ishin shfaqur kontradikta midis disa institucioneve dhe Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Edhe nëse propozimi për rishikimin e Kushtetutës në këtë pikë do të ishte i arsyeshëm dhe i efektshëm, ai u kompromentua rëndë për shkak të veshjes së oportunitetit politik. *Së katërti*,

problemet politike që shfaqen në këto kategori vendesh, janë të shumta për shkak të mungesës së kulturës demokratike. Por, nëse klasa politike do të rendte pas ndryshimit të Kushtetutës për zgjidhjen e tyre, atëherë do të sillte një tranzicion pambarim. Si përfundim, në vendet në tranzicion më i domosdoshëm është formimi i edukatës dhe i kulturës politike, çka do të shpinte në një stabilitet të padiskutueshëm. Kjo mund të realizohet me forma nga më të ndryshmet. Por, më e frytshme është, padyshim, respektimi i Kushtetutës dhe i ligjeve nga klasa politike dhe nënshtrimi i të gjithëve ndaj Kushtetutës, si ndaj një tempulli të shenjtë.

Sistemet zgjedhore në Europë

*Jozefina Topalli
Nënkryetare e Kuvendit
të Shqipërisë*

Pamja e përgjithshme është një shqyrtim i rregullave dhe mekanizmeve të përdorura në zgjedhjet demokratike në parlamentet e Europës. Përparësia e saj, siç ndodh në çdo studim të kësaj natyre, është që të bëjë një paraqitje të lehtë për t'u lexuar dhe për t'u përdorur.

Ndodh shpesh që informacioni bazë, e megjithatë thelbësor, mbi punimet e parlamenteve, është i shpërndarë dhe i vështirë për t'u gjetur. Ndaj grumbullimi i të dhënave i lejon lexuesit të marrin njohuri për sistemet zgjedhore europiane dhe për elementet e debatit politik në lidhje me to.

Të gjitha sistemet zgjedhore përpiqen të mbajnë parasysht të paktën disa ose të gjitha karakteristikat e mëposhtme. Ajo që është më e rëndësishme prej tyre ka prirje të përcaktojë parapëlqimin e njerëzve për sistemin zgjedhor.

a) Sigurimi i një parlamenti përfaqësues.

Parlamentet duhet të përfaqësojnë popullsinë që i zgjodhi, si nga ana e mbështetjes politike, ashtu dhe nga ajo rajonale dhe etnike. Ato zakonisht përfshijnë pikëpamje sa më të gjera që të jetë e mundur të të gjitha pjesëve të popullsisë.

b) Bërja e zgjedhjeve të kapshme dhe kuptimplota

Zgjedhjet janë thjesht një mjet për të arritur qëllimin. Votuesit duhet ta ndjejnë se pjesëmarrja e tyre do të sjellë një ndryshim në lidhje me rezultatin, ose për ndryshe ata do të vazhdojnë gjithnjë e më shumë të mos marrin pjesë, duke e minuar legjitimitetin e rezultateve.

c) Sigurimi i stimujve për pajtim.

Sistemet zgjedhore mund të jenë një mjet për menaxhimin e konflikteve. Në shoqëritë ku ka përçarje të thella, për krijimin e koalicioneve shpeshherë partive u duhet ta hedhin vështrimin përtej bazës së tyre qendrore të mbështetjes. Po kështu, duke pasur të gjitha palët të përfaqësuar në parlament, të gjithë partitë kanë pjesën e tyre në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nëpërmjet kuadrit institucional.

ç) Mundësimi i qeverisjes së efektshme dhe të qëndrueshme

Sistemi duhet t'i mundësojë qeverisë në pushtet të nxjerrë legjislacionin, të drejtojë ekonominë dhe të zbatojë detyra të tjera të qeverisjes. Sistemi duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë, që të mos favorizojë një parti në kurriz të të tjerave.

d) Vënia para përgjegjësisë e qeverisë dhe e përfaqësuesve për veprimet e tyre.

Ky është një nga gurët themeltarë të sistemeve zgjedhore. Ata duhet të sigurojnë kontrollin e veprimeve të individëve të zgjedhur dhe të krijojnë mundësinë që në intervale kohe të rregullta të largojnë ata, të cilat elektorati ndjen se nuk janë më të përshtatshëm për atë detyrë.

dh) Nxitja dhe respektimi i opozitës parlamentare.

Për të qenë të efektshme, qeveritë gjithashtu kanë nevojë të kenë një opozitë e cila të vlerësojë propozimet në mënyrë kritike, të mbrojë interesat e atyre që nuk janë të përfaqësuar në qeveri dhe të risigurojë elektoratin se ekziston gjithmonë mundësia që qeveritë të ndryshojnë në një kohë të mëvonshme.

e) Aspekte praktike

Hartimi i një sistemi të përsosur zgjedhor mund të jetë një ushtrim fitimprurës akademik, por në qoftë se votuesit nuk mund ta kuptojnë atë dhe të mendojnë se ai është i besueshëm, ata nuk do ta mbështesnin. Veprimi i tij

duhet të jetë transparent dhe të sjellë rezultate që njerëzit t'i pranojnë si të drejta.

SISTEMET MAXHORITARE

Sistemet maxhoritare ose pluraliste përfaqësojnë kategorinë e sistemit më të vjetër e më të thjeshtë zgjedhor, në bazë të parimit se cilido kandidat që merr shumicën e votave në një zonë zgjedhore gjykohet i zgjedhur. Puna e parë e këtij sistemi është krijimi i një qeverie të efektshme. Tri llojet e mëposhtme të sistemeve maxhoritare veprojnë në bazë të zonave zgjedhore me një anëtar:

a) *“Kapërcimi i pragut” ose shumica e thjeshtë*

Ky është sistemi më i drejtpërdrejtë zgjedhor dhe aplikohet në Mbretërinë e Bashkuar, në SHBA, Kanada dhe në Indi. Për të fituar, kandidati ka nevojë të marrë një votë më shumë se ndonjë kandidat tjetër. Meqenëse pragu minimal (domethënë një nivel minimal, zakonisht një përqindje e votës popullore që kërkohet të marrë një parti, që të lejohet të fitojë përfaqësim parlamentar) është rrallëherë pjesë e këtij sistemi dhe nuk kërkohet shumica absolute, fituesi, megjithatë, mund të fitojë me një përqindje relativisht të vogël të votave.

b) *Raundi i dytë i shumicës ose shumica absolute*

Ky sistem kërkon që kandidati të marrë një votë më shumë se gjysma e votave të hedhura me qëllim që të zgjidhet. Nëse asnjë kandidat nuk merr aq shumë vota, mbahet një raund i dytë. Në këtë sistem, ose shumica e thjeshtë është e mjaftueshme në raundin e dytë, ose mbahen zgjedhje “përfundimtare” midis dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në raundin e parë, gjithashtu edhe nga pikëpamja e shumicës absolute. Franca dhe Ukraina të dyja përdorin variacione të këtij sistemi.

c) *Vota alternative*

Ky sistem, gjithashtu, kërkon të sigurojë se kandidati zgjidhet me shumicë

absolute, por zgjidhet në një raund të vetëm, duke përdorur votimin preferencial (domethënë duke shprehur një sërë preferencash).

- Sistemet maxhoritare janë të thjeshta. Ato nuk kërkojnë matematikë të ndërlikuar që të nxjerren rezultatet e tyre dhe nxisin transparencën, meqë votat kthehen lehtë në vende në parlament.
- Një sistem maxhoritar, ashtu siç synon të krijojë një qeveri të fortë, ashtu synon të çojë në një parti tjetër të fuqishme, siç ndodh në Mbetërinë e Bashkuar dhe në SHBA. Kjo krijon një arenë politike dinamike, ku qeveria ka nevojë të punojë shumë, sepse ekziston gjithmonë një alternativë frytdhënëse dhe e fuqishme që publiku mund ta zgjedhë për të zëvendësuar të parën.

SISTEMET PROPORCIONALE

Ndërsa sistemet maxhoritare japin modelin më të vjetër të sistemeve zgjedhore, sistemet e përfaqësimit proporcional aktualisht janë më shumë të përdorura në Europë. Këto sisteme synojnë të përqendrohen në krijimin e një dhome parlamentare që pasqyron me saktësi përbërjen e ndryshme të elektoratit. Të dy kategoritë kryesore të sistemit proporcional janë Lista Partiake dhe Vota e Vetme e Transferueshme. Të dyja këto ndikojnë ndjeshëm në krijimin e parlamenteve përfaqësuese.

Përmasat e zonës zgjedhore (që mund të quhet edhe “madhësia e distriktit”) është e rëndësishme, meqenëse ajo mund të ndikojë në atë se sa “saktësisht” rezultatet pasqyrojnë elektoratin e përgjithshëm. “Sistemi i plotë proporcional” e konsideron të gjithë vendin si një zonë të vetme zgjedhore, me vende të caktuara mbi një bazë *pro rata*, sipas numrit të votave të hedhura.

SISTEMET MIKSE

Ka një shkallë të sistemeve të cilat synojnë të vendosin një barazpeshë midis sistemeve maxhoritare dhe sistemeve proporcionale dhe përgjithësisht

kategorizohen si “sisteme mikse”. Ato mund të ndahen brenda tyre në sisteme, të cilat sjellin së bashku elemente të maxhoritarit dhe të proporcionalit, duke synuar të vendosin mekanizmin e shpërndarjes së vendeve, duke marrë përvojat më të mirat në të gjithë botën dhe sistemet ku mekanizmat maxhoritare dhe proporcionale përdoren në faza të ndryshme.

a) Vota në bllok ose e grumbulluar

Në këtë sistem të përzier votimi në raundin e parë, siç është përdorur në Tajlandë dhe Filipine, votuesit kanë një numër të barabartë votash me numrin e vendeve në parlament dhe janë të lirë t’i shpërndajnë ato ndërmjet të gjithë kandidatëve, megjithëse qëndron që një nga kandidatët mund të marrë të gjitha votat e një votuesi ose, ndryshe, kur votuesi mund t’i japë secilit kandidat një votë. Vendet shpërndahen midis kandidatëve që marrin shumicën e votave. Një variant i kësaj është “vota e partisë në bllok”, ku votuesit lejohen të votojnë për një parti të listës, ku rezultatet në listën e pranuar të kandidatëve të listës së partive fituese marrin të gjitha vendet në një zonë shumemërore. Shumica e deputetëve në Singapor dhe Ekuador zgjidhen sipas variantit të këtij sistemi.

b) Vota e përcaktuar

Përdoret në zona shumemërore. Votuesit mund të votojnë për kandidatë të ndryshëm në fletë votimet, por gjithmonë më pak se një numër vendesh që duhet të plotësohen. Kandidatët e votuar me më shumë vota zgjidhen. Ky sistem është përdorur në disa zgjedhje në Britaninë e Madhe në fund të shekullit të 19-të.

Ky variant i “sistemeve mikse” synon më tepër drejt “sistemit proporcional”.

c) Një votë e vetme e patransferueshme

Në këtë sistem, vende të ndryshme janë caktuar në secilën zonë. Megjithatë, çdo votues mund të votojë me një votë për njërin kandidat dhe ata kandidatë të cilët fitojnë shumicën e votave konsiderohen të zgjedhur.

Këto sisteme, megjithatë, përdorin mekanizma të ndara të maxhoritarit dhe proporcionalit për zona të ndryshme.

ç) Sistemi me anëtarë shtesë ose paralel

Një përqindje e vendeve që do të ndahen duke përdorur metoda maxhoritare, ndërsa vendet e mbetura përcaktohen sipas sistemit proporcional, zakonisht përdoret mbi baza rajonale ose me popullsi shumëkombëshe. Në Dumën Ruse, për shembull, vendet zgjidhen sipas një vote maxhoritare në zona njëemërore. Japonia përdor gjithashtu këtë sistem.

d) Sistem miks me anëtarë proporcionalë.

Ky sistem është shumë i ngjashëm me atë të anëtarëve shtesë, në të bashkohet votimi maxhoritar për një pjesë të vendeve dhe atij proporcional për listën e partive për vendet e tjera. Megjithatë, “në sistemin miks me anëtarë proporcionalë”, proporcionali i listës së partive kompenson ndonjë shpërpjesëtim të shkaktuar nga sistemi maxhoritar i zgjedhjes në rezultatin e vendeve të zonës. Për shembull, nëse një parti fiton 10 për qind të votave në rang kombëtar, por jo vende në zona, duhet të caktohen mjaft vende nga listat proporcionale që të sjellin përfaqësimin afërsisht tek 10 për qind të vendeve në parlament.

Ky sistem me mekanizmin e “kompensimit” përdoret në Gjermani, Hungari, Zelandën e Re dhe shihet si veçanërisht i dobishëm në mundësimin që u jep gjatë gjithë kohës partive të vogla, për të mbajtur një kuotë të drejtë të votës së popullit, në përfaqësimin lokal të zonës.

Diskutim për zgjedhjen e sistemit zgjedhor

Ilirjan Celibashi
Kryetar i KQZ-së

ÇFARË REALIZOJNË ZGJEDHJET?

Zgjedhjet “mekanikisht” realizojnë delegimin e pushtetit nga populli (zgjedhësit) te përfaqësuesit e tij (anëtarë të parlamentit etj). Në fakt, në zgjedhje populli delegon sovranitetin te këta përfaqësues. Janë këta që të grupuar formojnë institucionin që është mbajtës i sovranitetit të popullit. Ky sovranitet ushtrohet ose materializohet, të themi, nëpërmjet akteve juridike që ky institucion miraton. Ky delegim është i përkohshëm (çmohet sa është përkohshmëria) dhe, në periudha të caktuar, populli (zgjedhësi) ka të drejtën dhe mundësinë që të reflektojë nëpërmjet votimit për përfaqësuesit e tij.

Që ky grup njerëzish të kenë legjitimitetin (të drejtën) për ta ushtruar këtë pushtet, duhet që delegimi i tij (i pushtetit, sovranitetit), nga zgjedhësit, të jetë me vullnet të lirë, jo i cënuar ose i deformuar. Kjo do të thotë që zgjedhjet janë dhe duhet të jenë të lira, të drejta, dhe të ndershme. Pra, thjesht, do të thotë që këta përfaqësues (deputetë-parlamentarë), të jenë pikërisht ata që zgjedhësit kanë zgjedhur, kanë vendosur të jenë përfaqësues të tij.

Diskutimi i lindur te ne për reformën zgjedhore, i cili mundet ose jo të përfshijë edhe sistemin zgjedhor, ka ardhur për shkakun se një pjesë vlerëson se shprehja e këtij vullneti nuk është reale. Sa e vërtetë është kjo dhe për cilat shkaqe, unë këtu nuk do të ndalem. Gjykimet janë dhënë, mundet të jepen dhe të tjera, por fakti është se ka një diskutim për një reformë zgjedhore

e cila, me sa është thënë, shkakun dhe burimin e ka në “dyshimin mbi përfaqësimin real në pushtetin legjislativ”.

Pra, çmohet se “mekanizmi” që realizon këtë proces delegues te ne nuk funksionoi mirë.

Mendoj se shikimi si shkak vetëm i sistemit, nuk është një përfundim i bazuar mbi një analizë plotë, të thellë dhe të bërë me realizëm. Kjo nuk do të thotë se unë mendoj se është një gabim të diskutohet për sistemin dhe për çfarë do të vendoset më pas.

Fillimisht dua të theksoj se nuk ka asnjë sistem zgjedhor i cili siguron delegimin pa cen të vullnetit të zgjedhësit të përfaqësuesit e tij. Në qoftë se do të ishte një i tillë, ai do të ishte skualifikuar dhe nuk do të trajtohej nga teoria për sistemet zgjedhore. Pra, të gjitha sistemet zgjedhore që njihen dhe janë zbatuar deri tani kudo në botë, në një mënyrë ose në një tjetër sigurojnë në mënyrë të ligjshme (kushtetuese) këtë delegim të pushtetit. Pra, institucionet legjislative, të formuara pas zgjedhjeve të organizuara në bazë të çdo sistemi zgjedhor, përfaqësojnë në çdo rast vullnetin e popullit (zgjedhësit). Kjo do të thotë se edhe sistemi që ne kemi zgjedhur (i sanksionuar në Kushtetutë), në vetvete nuk deformon vullnetin e zgjedhësit.

Unë mendoj se ky vullnet dëmtohet nga “mekanizmi” që materializon sistemin, nga procesi zgjedhor. Neni 64 i Kushtetutes mundet të kishte një formulim tjetër, por unë mendoj se për mënyrën se si ai sanksionon ndarjen e rezultatit zgjedhor, në parim, nuk është i kritikueshëm. Por kjo nuk do të thotë se këtij sistemi nuk mundet t’i bëhet kritikë.

Kuptohet që në zgjedhjen e një sistemi zgjedhor nga një vend i caktuar (kupto dhe sistem politik i caktuar), autoritet kompetente në përzgjedhje marrin ose duhet të marrin në konsideratë shumë faktorë. Këta mundet të jenë historikë, politikë, kulturorë, etnikë, shoqërorë, gjeografikë etj. Në vende me një histori politike dhe shoqërore të konsoliduar shumëvjeçare (shekullore diku) është patjetër më e thjeshtë për të përcaktuar se cili sistem funksionon

më mirë. Të gjitha këto kanë të bëjnë me traditën. Tradita, ashtu si kudo, edhe në zgjedhjen e një sistemi ka një rëndësi dhe duhet të llogaritet.

Ndoshta për shkak të llojit të formimit tim profesional (jurist), unë mendoj se sistemi maxhoritar është sistemi më natyror zgjedhor. Këtu bashkësia, në mënyrë më të drejtëperdrejtë, zgjedh përfaqësuesin e vet. Pra, ky përfaqësues ka një identitet të treguar dukshëm, të njohur kur votohet dhe në mënyrë të natyrshme përfaqëson zgjedhësit e vet. Unë kam qenë në fakt adhures i këtij sistemi. Mendoj se është sistemi që në mënyrë të drejtëperdrejtë realizon përfaqësimin. Por sot, për shumë arsye, e kam të vështirë të them se mund të funksionojë këtu. Por edhe mundet.

E për të vazhduar, sa pak më sipër po trajtonim, Shqipërisë i mungon kjo traditë. Në këtë mënyrë është e vështirë të thuhet sot se ky sistem nuk funksionon dhe një tjetër mund të funksionojë më mirë. Në këtë kontekst, e para, çfarë do të kuptojmë me mosfunksionim dhe, e dyta, pasi të kemi dhënë përgjigje për të parën, për shkak të kujt është ky mosfunksionim? Për shkak të sistemit ose të mekanizmave që e zbatojnë këtë sistem?

Mendoj se, përpara se të bëjmë analizën e sistemit, duhet të vlerësojmë se sa të përshtatshëm, sa të gjetur janë mekanizmat implementues të sistemit. Është e rëndësishme të thuhet se gjetja e këtyre mekanizmave në përgjithësi, nuk duhet të ketë në themel të vet interesin e ngushtë (pra, po them të ngushtë) politik.

Teoritë e ndryshme mbi sistemet zgjedhore dhe konfigurimin e tyre konsiderojnë se zgjedhja e sistemit asnjëherë nuk bëhet në një zbrazëti interesash politike. Në fakt, konsiderimi i avantazheve politike është thujse gjithmonë një faktor në zgjedhjen e sistemit zgjedhor. Përgjithësisht partitë politike në zgjedhjen e një sistemi ose në ndryshimin e atij ekzistues kërkojnë të propozojnë rregulla të cilat mund t'u japin avantazh në zgjedhjet e ardhshme. Prandaj është e dobishme që zgjedhja e sistemit ose ndërhyrjet në ekzistuesin, të bëhen sa më përpara datës së zgjedhjeve. Historia e viteve të fundit dhe në vendet me demokraci të konsoliduar ka treguar se kur zgjedhja e sistemit

është bërë duke llogaritur interesat e ngushta politike, partia politike që ka realizuar këtë sipërmarrje politike dhe ligjore, ka humbur zgjedhjet. Sugjerohet që zgjedhja e sistemit duhet të përcaktojë mirë se çfarë synohet të arrihet. Në radhë të parë, sistemi zgjedhor duhet të synojë të sigurojë stabilitet zgjedhor dhe efikasitet qeverisjeje. Kjo e fundit nuk do të thotë stabilitet politik i një qeverie në mënyrë të imponuar.

Sistemi zgjedhor duhet të sigurojë një përfaqësim të përshtatshëm të partive të ndryshme politike. Kështu, nuk duhet të ndodhë që një parti politike, e cila ka marrë përafërsisht 1/2 e votave në shkallë vendi, të mos mund të përfaqësohet në parlament me asnjë vend.

Ndërtuesit e institucioneve, pra, dhe zgjedhësit e sistemit zgjedhor, duhet të llogarisin:

- nuk ka një sistem më të mirë;
- nuk ka një zgjidhje institucionale unike;
- nuk ka asnjë mënyrë për të imponuar modele të dhëna.

Zgjedhja e sistemit zgjedhor lidhet dhe me aspekte të tjera, të cilat lidhen me votimin dhe procedurat e votimit. Lista e zgjedhësve, vendi dhe mënyra e numërimit, trajnimi i zyrtarëve zgjedhorë, njohja e zgjedhësve me procedurat, shpërndarja e qendrave të votimit, modeli i fletës së votimi, caktimi i kandidatëve, organet që administrojnë zgjedhjet etj., janë elemente të cilat ndikojnë kur vendosim të zgjidhet sistemi.

Duke pasur parasysh sa thamë më lart, duhet të kemi parasysh se zgjedhja e sistemit kërkon një reflektim mbi shumë elemente dhe faktorë. Në këtë mënyrë nuk do të jemi gjithmonë në dilemë mbi drejtësinë e zgjedhjes që kemi. Në qoftë se në zgjedhjen e sistemit, si pasoja që prodhon sistemi elektoral i zgjedhur, do të llogarisim vetëm interesin politik, fatet e subjekteve politike të caktuara, zgjedhja do të jetë gjithmonë problematike. Sistemi duhet të jetë i tillë që me kosto sa më të vogël (në kuptimin më të gjerë të koston), të sigurojë përfaqësim real të komunitetit dhe reflektim të qartë dhe të plotë të vullnetit të bashkësisë.

Teoritë mbi sistemin e zgjedhjeve konsiderojnë se, kur zgjidhet sistemi zgjedhor, është mirë të fillohet me një listë në të cilën duhet të përcaktohen rezultatet që kërkohet të arrihen dhe ato që kërkohen të përjashtohen, si kërkohet që të jetë parlamenti dhe qeveria etj. Pra, ne duhet të themi se çfarë kërkohet të arrijmë dhe pastaj të kërkohet se cili sistem i kënaq kërkesat tona.

Zgjedhja e sistemit elektoral është një nga vendimet institucionale më të rëndësishme për çdo demokraci. Përvojat ndërkombëtare këtë e pranojnë dhe shumë autorë tregojnë se shpesh zgjedhjet janë aksidentale.

Aftësia e të gjithë faktorëve duhet të jetë e tillë, që të mundësojë një zgjedhje e cila i largohet shumë zgjedhjeve kontekstuale. Në vendet me demokraci të konsoliduar, veç aktorëve që vendosin dhe dizenojnë sistemin zgjedhor, partitë politike dhe institucionet që ato përfaqësojnë, kanë një ndikim të fuqishëm struktura të shoqërisë civile.

Përsa parashtrova më sipër, mendoj se në këtë shkrim do të ishte e tepërt të trajtonim sistemet zgjedhore dhe si është shpërndarja e tyre në vende të ndryshme. Mendoj se në këtë rast do të kishim të bënim me një trajtim mekanik të çështjes, i cili nuk besoj se do t'i interesonte lexuesit të revistës.

Është e vështirë që të japësh një përfundim kategorik në lidhje me atë se duhet ose jo ndryshuar sistemi, kur një sistem nuk është testuar plotësisht (jo vetëm në kohë), si dhe kur në çdo zgjedhje (politike të përgjithshme) sistemi i zgjedhjeve është i ndryshëm. Një zgjidhje e mirë për të kaluar këtë problem do të ishte pjesëmarrja e të gjithë faktorëve në diskutim, analizë jo mbi bazë të interesave të çastit, konsensus sa më i madh ndërmjet palëve dhe të intersuarve. Qëllimi duhet të jetë qartësisht i treguar dhe i kuptuar.

Një gjë është mjaft pozitive në diskutimin që po bëhet. Koha kur po bëhet ky diskutim. Në këtë çast nuk është asnjëra palë nën presionin e zgjedhjeve politike (për në Kuvend) të pritshme. Besoj që asnjë nga palët nuk ka mundësi që të llogarisë plotësisht avantazhet që mundet t'i japë një zgjidhje e caktuar. Në këtë mënyrë besoj që zgjedhja do të ketë pëlqimin e një spektri të gjerë politik. Ky fakt përbën një faktor të rëndësishëm kur zgjidhet një sistem.

Koha për propocionalin

Henri Çili
Gazetar

Një sistem elektoral, “i mirë për të gjithë”. Sistemi zgjedhor, si origjinë dhe zgjidhje e krizës politike dhe institucionale.

A është sistemi elektoral më i rëndësishëm se edhe vetë kushtetuta e një vendi? Ka prova dhe arsyetime të shumta që të shpien tek përgjigja “PO”. Meqenëse është sistemi elektoral i zgjedhur ai që ndikon në mënyrën sesi formëzohet spektri politik, se si ndërtohet përbërja e Kuvendit, atëherë këtu nis gjithçka; ndërtimi i qeverisjes dhe insitucioneve, nis profili i ardhshëm i shtetit. Teorikisht, sistemi mazhoritar krijon një konfigurim politik, i cili frymëzon “luftën” e fortë politike, kompaktëson dy kampe, skualifikon aktorët e tretë e më tej dhe forcon shumë dy aktorët kryesorë, secili në njërin kamp. Kjo, nga ana tjetër, favorizon një vendimmarrje politike të shpejtë dhe operative, por që vjen e izoluar nga debati, një tip vendimmarrjeje si të thuash “bruto”, e cila nuk është korrektuar rrugës nga presioni i interesave të aktorëve të tjerë politike dhe jo të tillë.

Përkundrejt kësaj, sistemi proporcional vendos një raport thuajse të barabartë mes përqindjes së votave që partia fiton në zgjedhje dhe përqindjes së vendeve në parlament.

Ky sistem frymëzon një mjedis politik me më shumë aktorë, ku modifikohet fuqia e dy aktorëve kryesorë dhe rritet pesha në vendimmarrje edhe e aktorëve të tjerë. Shkurt sistemi proporcional inspiron marrëveshjen, kompromisin si mënyrën themelore të vendimmarrjes politike, kjo si në raportet e forcave brenda shumicave qeverisëse, ashtu dhe në mes të pozitës dhe opozitës.

Kjo e ngadalëson dhe e bën më të ndërlikuar procesin e vendimmarrjes politike, pasi në këtë rast rrugëkalimi i procesit të vendimmarrjes politike kalon në më shumë duar dhe për pasojë ai ka mundësi të modifikohet rrugës sipas interesave të grupeve dhe aktorëve vendimmarrës. Sistemi mazhoritar i përshtatet atyre vendeve ku demokracia është e fortë dhe me traditë të gjatë. Në këto vende procesi i vendimmarrjes politike është i shpërndarë nëpër shumë aktorë të shoqërisë, që janë jashtë politikës, por që në një formë ose në një tjetër kryejnë funksione politike. Në këto vende janë ngulitur standarde të tilla të demokracisë dhe rregullave të lojës sa është shumë e vështirë t'i prekësh. Nga ana tjetër, veprojnë institucione garante dhe grupe interesi jashtë politikës, të cilët bëjnë një lloj roje në hije të këtyre standardeve dhe marrin pjesë në vendimmarrjen korrente për të shkuar përpara. Këto lloj vendesh, e kanë thjeshtuar vendimmarrjen politike në pak aktorë politikë, dhe kanë instaluar bipolaritetin politik, si një formë të mjaftueshme të alternimit të pushtetit dhe vendimmarrjes politike.

Por aktorë të tjerë të shoqërisë, që nuk merren drejtpërsëdrejti me politikë, po që kryejnë shpesh funksione politike, janë shumë aktivë për të ndikuar në vendimmarrjen politike sipas interesave të tyre. Në demokracitë e konsoliduara numërohen të paktën gjashtë aktorë publikë që ndikojnë fuqishëm në jetën politike: sindikatat e punëtorëve, patronati (sindikata e sipërmarrësve), media, shoqëria civile, sistemi gjyqësor, bota akademike dhe universitare, si dhe kurora mbetërore aty ku ka mbretëri kushtetuese. Ky rast i kulluar është pikërisht Anglia.

Përkundër këtyre demokracive të konsoliduara, demokracitë e reja kanë parakushte krejt të kundërta. Në këto vende politika është praktikisht superqendra e vendimmarrjes politike dhe qeverisëse dhe nga kjo pikë duhet nisur kërkimi se çfarë sistemi elektoral i përshtatet, madje është i domosdoshëm në këto vende. Në demokracitë e reja aktorët e tjerë të shoqërisë ose janë shumë të dobët, ose janë shumë të varur nga pushteti dhe politika, duke krijuar një situatë ku praktikisht mbivendoset sfera politike më

atë shoqërore. Kështu në kushtet e një ekonomie të dobët dhe papunësie të madhe roli i sindikatave është i papërfillshëm, klasa e sipërmarrësve është pa ndonjë vetëdije të qartë politike dhe sundojnë interesat mafioze dhe korruptive, në këtë mënyrë shpesh ndikimi i tyre në vendimmarrjen politike është negativ; shtypi është i varur nga politika, larg pavarësisë dhe i kontrolluar ose prej pushtetit, ose i persekutuar prej tij, ose i lidhur me interesa mafioze; shoqëria civile është po ashtu pa shumë ndikim ose e politizuar; bota universitare mendimi akademik është anemik dhe gjendet në kushte mbijetese për shkak të mungesës së burimeve financiare për kërkim shkencor, sistemi gjyqësor është shumë i kontrolluar nga politika dhe i korruptuar. Në këto rrethana është domosdoshmëri që vendimmarrja politike apo pushteti të shpërndahet, që partitë e mëdha të “copëtohen” në nëngrupe më të vogla, që janë përfaqësuese të interesave më të qarta të shtresave shoqërore dhe grupeve të interesit. Shqipëria mund të kualifikohet në grupin e dytë të vendeve, pra, një vend ku demokracia është ende shumë e brishtë, dhe ku politika është superqendra e vendimmarrjes politike.

Nga parlamenti i parë pluralist i 31 marsit 1991, deri tek parlamenti i para 24 qershorit, nën efektin edhe të natyrës së konfrontimit politik (konfrontimi i ashpër në garat e para elektorale) dhe i ndihmuar fuqishëm nga sistemi zgjedhor i karakterit mazhoritar, kemi patur në Kuvend shumica dërrmuese të një partie të vetme. Kjo do të thotë se respektivisht, herë socialistët dhe herë demokratët kanë patur mbi 2/3 e vendeve në Kuvend. Kjo shifër që dëfton një fuqi parlamentare të frikshme, në thelb, ka përcaktuar natyrën e jetës parlamentare dhe politike të vendit, dhe jo thjesht të dhënat personale të Nanos dhe Berishës.

Përparësitë direkte të sistemit proporcional

Përfaqësimi real i partive në Kuvend: Sistemi proporcional do të eliminonte hendekun mes përqindjes së votave që partitë marrin në votimin e përgjithshëm dhe përqindjes së vendeve në parlament. Kjo u jep fuqi reale partive dhe nuk ua shton ose heq atyre artificialisht atë fuqi dhe përfaqësim që u jep

populli.

Përfaqësimi i detajuar i shtresave shoqërore në Kuvend.

Një ligj proporcional do të krijonte mundësinë që partinë e vogla ose më saktë partitë nga partia e tretë e më tej, të mund të mbijetonin dhe të kishte në Kuvend një shprehje më të detajuar të realitetit shoqëror, shtresëzimit shoqëror, që vazhdon të ndryshojë në dinamikë të shpejtë.

Çekstremizimi i partive të mëdha: Po ashtu, dy partitë e mëdha që janë aktualisht do të çliroheshin edhe nga detyrimi për të përfaqësuar ato vetë interesat e pjesëve ekstremale të spektrit, përkatësisht të së djathtës dhe të së majtës. Ekstremistët në kushtet e "shfarosjes" ose më saktë të shfaktorizimit të partive të vogla janë të detyruar që për t'u përfaqësuar, të enden në "oborrin" e partive të mëdha. Sistemi proporcional, që sjell një shpërndarje më të ekuilibruar të vendeve në Kuvend eliminon edhe teorikisht që një parti e vetme të fitojë 2/3 apo 3/5 e vendeve në Kuvend. Kjo siguron një kontroll real të opozitës në jetën e vendit dhe e bën atë faktor në vendimmarrje. E gjithë kjo imponon një lojë politike që bazohet të negociimi dhe kompromisi dhe jo tek vullneti i kartonave jeshil të një partie, edhe jashtë vullnetit të partive politike dhe liderave të tyre.

Fundi i ndarjes "veriu - blu , jugu i kuq" Edhe nga pikëpamja e interesit kombëtar i jepet fundi "ndarjes elektorale në veriu -blu dhe jugu- i kuq. Kjo do të thotë së në Kuvend do të jenë përfaqësuar proporcionalisht edhe demokratët e Skraparit edhe socialistët e Shkodrës. Ka dhjetë vjet që në zonën Shkodër -Malësi e Madhe ka mbërritur në Kuvend vetëm një deputet socialist, ndërsa e majta ka njëmbëshetjë prej rreth 30-35 përqind. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për zonë të tëra në jug për demokratët. *Thjeshtëzimi i praktikës së zgjedhjeve me një raund:* Nga pikëpamja praktike votimi proporcional me një raund eliminon coptimin e procesit elektorale në shumë raunde, thjeshtëzon votimin. Kjo ul mundësitë e manipulimit të zgjedhjeve në raundet pasardhëse dhe, për më tepër, i jep fund prekjes së një principi të votimit, atij të "paritetit të votës". Të gjithë votuesit kanë të

njejtin informacion për kandidatët dhe partitë, duke votuar në të njëjtën ditë. Duke eliminuar kandidatët direktë, zbutet fushata në bazë, ku deri tani konfrontimi mes “bandave të kandidatëve” ka shkuar edhe më thellë se lufta në qendër.

Kuvend më elitar, fund i klientelizmit politik: Lista proporcionale krijon mundësinë e një Kuvendi më elitar, nga pikëpamja e kualitetit të deputetëve, në kushtet kur bashkë me mazhoritarin bie edhe nevoja e partive për “mjekun a mësuesin lokal, i cili ka emër të mirë dhe reputacion në zonë”. Rritja e pragut për futjen në Kuvend deri në 4- 4.5 % pas një apo dy zgjedhjesh do të dekurajonte praninë e partive të vogla. Nga ana tjetër, partitë e mëdha në kushtet e sistemit proporcional nuk janë më të detyruara për koalicione paraelektorale me parti të cilat nuk kanë mbështetje të qartë në elektorat, pasi sistemi proporcional krijon kushte për koalicione paelektorale, kur secili ka mundësi që të verifikojë mbështetjen në elektorat.

Një formule elektorale që i kënaq të gjithë: Një sistem elektorale ka dy funksione kryesore; ai duhet të prodhojë përfaqësimin në Kuvend të tendencave të shoqërisë dhe grupeve shoqërore, dhe nga ana tjetër, ai duhet të sigurojë një kombinim të tillë të forcave në Kuvend që të bëhet e mundur qeverisja e vendit. Shpejt e shpejt mund të themi se sistemi mazhoritar i pastër prodhon një shumicë qeverisëse shumë të qartë, duke i hyrë shumë në hak përfaqësimit të grupeve shoqërore në Kuvend. Kurse për sistemin proporcional nuk mund të thuhet se është inversi i kësaj situatë, pra, që ai siguron përfaqësim besnik në Kuvend të grupeve shoqërore, por nuk prodhon qeverisje, pasi nuk prodhon një shumicë të qartë. Në këtë kuptim duhet gjetur një mekanizëm që e korrigjon sistemin proporcional, tek një prej funksioneve kryesore që është prodhimi i “qeverisjes”, pa prekur në mënyrë thelbësore funksionin tjetër bazë, përfaqësimin. Ka dy mekanizma me anë të të cilave arrihet pikërisht kjo. Mënyra e parë është “primi elektorale”, që do të thotë “shpërblimi” i partisë që del e para në zgjedhje më një numër të tillë deputetësh, derisa kjo parti të kapërcejë 51% të vendeve në

Kuvend. Me anë të këtij mekanizmi, zgjedhjet arrijnë të prodhojnë një qeverisje të qartë. Mekanizmi i dytë është rritja e pragut që duhet të kalojnë partitë për t'u futur në Kuvend dhe kalimi i të gjitha përqindjeve të votave të partive që mbesin poshtë pragut në favor të partisë fituese, e cila në këtë mënyrë të forconte pozitat dhe kjo shton shanset për të prodhuar një qeverisje vetëm ose në koalicion me parti të tjera. Nga ana tjetër, përmes këtyre dy mekanizmave jo vetëm që prodhohet një qeverisje, por nuk preket përfaqësimi i partive të tjera poshtë të dytës, (varianti i dytë, pra, ai i kalimit të përqindjeve poshte pragut, në favor të partisë fituese) ose ai preket fare pak, (varianti i parë, ai i primit elektoral)

Një ligj elektoral “i mirë për të gjithë” është ai që do të duhej që të shmangte përvojën negative të mazhoritarit dhe do të korrigjonte defektet teorike të një sistemi proporcional. Një sistem i pastër proporcional me 101 vende dhe një prag parlamentar prej 4 %, ku përqindjet e partive që nuk kalojnë pragun, ia kalojnë partisë që ka fituar më shumë në zgjedhje, për ta ndihmuar atë në formimin e qeverisë. Ky version është në interes si të PD së, ashtu dhe të PS-së. Mund të arrihet një konsensus me partitë e vogla që pragu parlamentar mund të rritej gradualisht deri në 4% gjatë dy ose tri legjislaturave të ardhshme. Kjo do të thotë së për këto zgjedhje, pragu mund të rrinte kaq sa është, pra 2.5 %, katër vjet me vonë mund të shkonte 3 % dhe në legjislaturën e tretë mund të fiksohej në 4 %.

Pse i inteson ky version PD-së: Ky version i intereson edhe partive të mëdha. Partia Demokratike këto dhjetë vjet e ka pësuar nga “rrjedhja e elektoratit”. Nga natyra, elektorati i djathtë nuk është militant dhe është praktikisht i identifikuar me lidërshpin. Në këtë kuptim, e djathta ka humbur dhe i ka lënë indiferentë të gjithë ata votues që, për një arsye ose një tjetër, nuk identifikohen më me lidërshpin e PD dhe Berishën. Asaj, pra, i intereson që të shfrytëzojë kapacitete elektorale që dalin jashtë mundësisë që posedon lidërshpi i saj aktual ose i nesërm dhe të ndante nesër pushtetin me ta. Sistemi i pastër proporcional do të krijonte mundësinë e zhvillimit real dhe

shprehjes së formacioneve të tjera të së djathtës së nuancuar (e djathtë më liberale, më e moderuar, më radikale apo edhe më ekstremiste se PD- ja vetë) dhe kështu do të mblidhej çdo votë e djathtë. Në ato zgjedhje kur PD është partia kryesore, ajo është e favorizuar nga ky version, pasi asaj i shtohen edhe përqindjet e të gjitha partive, të cilat nuk arrijnë të kapërcejnë pragun dhe, në këtë mënyrë, ajo ka shanse të fuqizohet për të arritur e vetme formimin e qeverisë ose e bën atë shumë të fuqishme në kuadrin e një koalicioni për të arritur formimin e qeverisë. Kur PD ose e djathta është në opozitë, ajo ruan me besnikëri në Kuvend të njëjtën përqindje votash që ka fituar në elektorat, dhe në këtë mënyrë ajo është një opozitë e fuqishme dhe me përmasa reale, në përputhje me mbështetjen popullore.

Pse i intereson ky version PS: Elektorati socialist karakterizohet nga një angazhim i qartë dhe i vendosur në favor të forcës së tij politike, që do të thotë se votuesit tradicionalë janë votues besnikë dhe janë pak të prekur nga abstenimi në zgjedhje. Këtë e dëshmon edhe vetë statistika elektorale e kësaj partie. Nga viti 1992 deri më sot, me përjashtim të zgjedhjeve të vitit 1997, socialistet kanë ruajtur pak a shumë të njëjtin numër votuesish besnikë. Shkurt, partia socialiste ka një trupë votuese të qëndrueshme, e cila në kushtet kur abstenimi elektor po rritet shumë, bën që kjo parti të ketë një përparësi në raport me të djathtën. Në zgjedhjet kur partia socialiste është favorite e pushtetit, asaj i shtohen edhe përqindjet e votave të partive të vogla dhe në këtë mënyrë është shumë më e fuqishme për të formuar qeverinë vetëm ose në koalicion. Në zgjedhjet, kur partia socialiste nuk është favorite për të marrë pushtetin, ajo ruan në Kuvend besnikërisht të njëjtën përqindje votash, sa është përqindja e votave të fituara në zgjedhje.

Pse i intereson partive të vogla: Është apriori e qartë se partitë e vogla janë ato që kanë më shumë interes për këtë formë të sistemit elektorale. Bile kjo është një çështje për jetë a vdekje e këtyre partive, për të mbijetuar në tregun politik. Por do të ishte shkatërrimtare që për momentin pragu për futjen në parlament të ngrihej deri në 4 përqind. Shumica dërrmuese e partive

të vogla aktuale parlamentare nuk do ta kapërcenin këtë prag dhe sigurisht që ato nuk do ta jepnin konsensusin për këtë prag që tani. Po ashtu nuk do të ishte në interes të jetës parlamentare që ky prag të ishte kaq i lartë që tani, kur partitë e vogla kanë dhjetë vjet që "diskriminohen" dhe rrënohen nga ligji mazhoritar (më pak vende në Kuvend, më pak subvencione shtetërore, më pak vëmendje publike etj). Mund të arrihet një konsensus që pragu parlamentar mund të rritej gradualisht deri në 4% gjatë dy ose tri legjislativave të ardhshme. Kjo do të thotë se për këto zgjedhje pragu mund të rrinte kaq sa është, pra 2.5 %, katër vjet më vonë mund të shkonte 3 % dhe legjislativën e tretë mund të fiksohej në 4 %.

Ky tekst është një përmbledhje e esesë "Shumica që na mund: një kritikë për sistemin mazhoritar në Shqipëri, një skicë për nevojën e sistemit proporcional" të autorit. Eseja është botuar nga Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, në kuadrin e një programi për të promovuar kërkuesit e rinj në shkencat politike të publikojnë punimet e tyre.

Disa reflektime për integrimin europian

Eno Ngjela

Në fillim të muajit tetor Bashkimi European shpalli planet e veta drejt zgjerimit, për të përfshirë valën e parë të vendeve të Europës Lindore dhe Qendrore në fillim të vitit 2004. Ndonëse kjo është një ngjarje me një impakt të madh për zhvillimet ekonomike, politike dhe sociale të vendeve anëtare, si dhe të atyre që do t'i bashkohen organizatës, ka vend për reflektime dhe për diskutime. Vullneti politik drejt zgjerimit po provohet gjithmonë e më shumë të jetë një shenjë e angazhimit të fuqishëm drejt vlerave demokratike dhe tregut të lirë, duke institucionalizuar përpjekjet e përbashkëta të vendeve europiane në një rrugë të përbashkët drejt së ardhmes.

Ndërsa vendet që u është ofruar shansi të bëhen anëtare të Bashkimit, kanë shumë të drejtë të ndihen entuziaste për këtë arritje, për të cilën ata kanë punuar gjatë dekadës së fundit, vendet e tjera, ku bën pjesë dhe Shqipëria kanë në të njëjtën kohë të drejtë që të ndihen se po mbeten mbrapa. Kësaj nuk do t'i jap shumë rëndësi në këtë artikull, meqë nuk ka vend për shumë debate e meqë askujt dhe asgjëje nuk mund t'i vihet faji përveç shumë faktorëve - të gjithë me origjinë shqiptare. Aty ku mund të ngrihet një diskutim është fakti se si kjo perde e artë¹, që po ulet në Europë, do të ndikojë mbi valën e dytë të zgjerimit. Ka çështje të cilat nuk deklarohen vetëm për të qenë politikisht korrekt, por megjithatë, po të konsiderohen mund të bëhen objekt spekulimi fare kollaj për të nxjerrë konkluzione aspak optimiste. Ka

¹ Defining the borders of the new Europe, World Affairs, Spring 2002

shumë *elemente politike, ekonomike, historike ose fetare* që nuk e favorizojnë Shqipërinë në mes të disa vendeve të tjera të Europës Jug-Lindore, që të jetë një vend kandidat mbi të cilin shpresat e një anëtarësimi jo të largët në Bashkimin European do të ishin sadopak pozitive. Megjithatë, mbase nuk do të ishte fort frytdhënëse të përfshihemi në një analizë që nuk do të ndihmonte në gjenerimin e një angazhimi më të madh drejt procesit të integritimit.

Në këtë shkrim do të theksoj nevojën për një debat institucional dhe publik, për të paraqitur një kuptim më të mirë të procesit të integritimit, me qëllim që të krijohen bazat e shëndosha që do t'i mundësojnë aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë të bëhen gati drejt këtij qëllimi vendimtar. Nuk është herët për të filluar të mendojmë dhe të kuptojmë valën e parë të zgjerimit, me qëllim që të përgatitemi mirë deri në çastin që do të vijë radha e Shqipërisë. Do të ishte e vlefshme të konsideronim si fillim bagazhin institucional të vendit nën këndvështrimin e anëtarësimit në Bashkimin European.

Cilat janë dobësitë tona nga pikëpamja e konceptimit, ndërtimit dhe eficiencës institucionale që duhen vënë në dukje dhe adresuar, me qëllim që të realizohet një hyrje sa më pak problematike në BE?

Për një përfshirje sa më rezultative në këtë argument duhet të bëhet një rishikim i hollësishëm i institucioneve shqiptare dhe se sa të ingranuara janë ato për të qenë gati nga pikëpamja funksionale, për të qenë pjesë e Bashkimit European. Megjithatë, kjo kërkon një analizë të thellë dhe të gjerë. Për çastin, në këtë shkrim do të përqendrohemi te parlamenti, meqenëse ai është një nga institucionet kryesore, progresi i punës së të cilit do të vlerësohet në mënyrë konstante në kriterin e Demokracisë dhe Sundimit të Ligjit.²

² Commission of European Communities, Commission Staff Working Paper, "Albania Stability and Association Report" (Brussels, 5 April 2002).

Megjithëse një shtet relativisht i pjekur e me një përvojë të përfillshme në ndërtimin e institucioneve (jo detyrimisht një përvojë e mirë, po sidoqoftë diçka që ka vlera), Shqipëria ofron një bagazh të varfër në diskutimet parlamentare, pasi ndikimet e klanit kanë qenë zotëruese mbi konceptimet ideologjike, siç ndodh në vende të tjera. Parlamentet e periudhës paskomuniste në Shqipëri reflektojnë në përgjithësi një asamble kombëtare, ku ndarja e vendeve ka të bëjë fare pak ose aspak me parimet ose politikat dhe kjo në sajë të faktit që spektri politik nuk para është ndarë sipas qëndrimeve të sakta dhe të ndryshme ideologjike. Kjo është një dukuri që ndodh shpesh në vendet ish-komuniste të Europës Lindore në të cilat partitë politike nuk reflektojnë përgjithësisht ndarjet tradicionale, që ne jemi mësuar të shikojmë në linjat e partive konservatore apo të majta. Ky argument është shumë i vlefshëm në Shqipëri, ku ndarja midis partive politike nuk është aspak e qartë, nëse do të ishim modestë në përcaktim. Nga pikëpamja e angazhimit drejt integritit, kjo është më se optimale, pasi nuk ka argumente për aspiratat drejt futjes në NATO-s apo BE-së. Megjithatë, nga pikëpamja strategjike, një vështrim më i thellë do të zbulojë një strukturë me një sens të përkohshëm, ku deputetët në përgjithësi kanë shumë pak ose aspak për të thënë në një debat substancial për integrimin dhe, aq më tepër, që të jenë të aftë të gjenerojnë konceptime afatgjata, për ta arritur këtë qëllim.

Do të kishte qenë mëse normale dhe e përshtatshme, që tani të kishin filluar diskutimet për çështjet e standardizimit legjislativ dhe impaktit që ai do të ketë mbi procedurat e punës së Parlamentit. Nuk do jetë e largët dita mbase kur do të jetë i nevojshëm krijimi i një Komisioni për Legjislacionin Europian sipas përvojës së vendeve të tjera që janë pranë hyrjes në BE dhe që do të siguronte kompatibilitetin e proceseve të formulimit të ligjeve. Ose çka do të ishte edhe me më shumë rëndësi: të konsideronte çështjet e sovranitetit, që do të detyrohemi të humbasim ose me ato të sovranitetit të njehsuar siç i referohet ndryshe në BE. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për shtetet e vogla mbi të cilat impakti i kësaj konsekuence do të ishte i një

shkalle më të madhe. Sipas Joseph Frankel³, në ditët e sotme të gjitha shtetet janë duke u përballuar me një tkurrje të vazhdueshme të sovranitetit të tyre. Në linjën e këtij diskutimi ne mbase jemi të etur për t'iu bashkuar Bashkimit Europian, por në të njëjtën kohë duhet të kemi parasysh se dhe pas disa dekadave të një veprimtarie funksionale dhe disa traktateve, përsëri ka pikëpyetje në nivelin e qeverive kombëtare të shteteve anëtare në lidhje me autoritetin e fundëm legjislativ. Megjithëse ne kemi një rrugë të gjatë për të bërë, është shumë me rëndësi që debate dhe pikëpyetje të kësaj natyre të fillojnë të adresohen në sesione të hapura të komisioneve parlamentare, gjatë së cilave publiku të ketë mundësi të kuptojë se në cilat duar do të varet e ardhmja e tyre. Jam i habitur, që askush deri më sot nuk e ka hapur debatin për votimin mbi bazën e maxhorancave cilësore, i cili nuk është aspak favorizues për vendet e vogla dhe që parashtron një çështje serioze siç është negociimi brenda një strukture burokratike e cila pritet të jetë edhe më e tillë pas zgjerimit. Nuk është herët që të përcaktojmë se cilat do të jenë çështjet me të cilat ne duhet të përgatitemi të luajmë dhe të negociojmë për sa i përket Politikave të Përbashkëta Bujqësore (CAP), Politikave të Përbashkëta të Sigurisë dhe të Jashtme (CSFP) ose për ndonjë nga kolonat kryesore të tjera të BE-së. Me gjithë zhvillimet pozitive dhe një mjedis nxitës politik në vend, që shoqërohet me një angazhim të qartë drejt integritimit, është i vërtetë fakti se në Shqipëri një çështje e caktuar politike shpesh diversifikohet dhe bëhet e vështirë që të arrihet një marrëveshje në sajë të shumë ndikimeve ose këndvështrimeve, apo dhe një kujtese të gjatë tradicionale. Ky këndvështrim bëhet edhe më i konsiderueshëm, veçanërisht kur argumentet ekonomike do të jenë gjithmonë e më shumë mbizotërues. Ne jemi të gjithë dëshmitarë të debateve të gjata rreth “luftës” për ndikim ekonomik në Shqipëri dhe se sa të vështira bëhen këto çështje kur ka një varietetet interesash dhe

³ Quoted at Hyde-Price Adrian, “The International Politics of East and Central Europe” (Manchester University Press, Manchester, 1996) p. 287.

investimesh si ekonomike, ashtu dhe politike. Në BE këto debate do të vazhdojnë dhe për më tepër vendimmarrja jonë do të kufizohet nga ndikimet dhe negociimet që ndodhin në Bruksel. BE-ja shpesh konsiderohet si një makineri e madhe negociimesh. Dhe kjo makineri, për fat jo të mirë tonin, nuk lejon shumë hapësirë për manovër për vendet e vogla. Kështu që ne duhet të përgatitemi të shkojmë atje me qëndrime të përbashkëta për çështjet sociale, politike, por edhe më shumë për ato ekonomike, nëse vërtet do ta shfrytëzojmë me frytshmëri pjesëmarrjen tonë në BE. Përndryshe, të gjitha slloganet politikisht korrekte, se ne jemi pjesë e pandarë e Europës, mbeten thjesht të tilla dhe nuk do t'i shërbejnë askujt.

Gjatë zgjerimit të viteve '80 debati u vërtit rreth argumentit se një bashkim më i madh nuk do të ishte detyrimisht më funksional, duke hedhur kështu dyshime mbi anëtarësinë e Greqisë, Spanjës dhe Portugalisë. Këtë radhë argumenti është më i fortë dhe ndoshta do të jetë edhe më i fuqishëm në të ardhmen. Mbi çdo argument të viteve '80 qëndronte një vullnet politik, për të përfshirë vendet në fjalë në sajë të problemeve strukturore ndërkombëtare. Një argument i ngjashëm qëndron për zgjerimin e NATO-s sot në sajë të fushatës kundër terrorizmit të udhëhequr nga SHBA-ja. Europa na ofron një skenar të ndryshëm, ku shtetet anëtare, me gjithë bashkimin e ngushtë ekonomik, kanë në të njëjtën kohë të drejtën e fjalës së fundit për çështjet e sigurisë dhe të politikës së jashtme sipas këndvështrimit të tyre. Si rrjedhojë, një Europë më e madhe ka për ta pasur më të vështirë ta gjejë të njëjtin vullnet për të promovuar zgjerimin e mëtejshëm drejt Europës Jug-Lindore – përfshirë Shqipërinë. Dhe ka fakte për mbështetjen e këtij argumenti aspak nxitës. Eurobarometri i tetor-nëntorit 2001 e vendos Shqipërinë në vendin e fundit për sa i përket mbështetjes nga publiku në Europë për një anëtarësim të mundshëm të saj në BE, me shifrat shqetësuese prej 52 për qind kundra dhe 27 për qind pro⁴. Kjo na sjell në një nga çështjet më të rëndësishme të

⁴ http://europa.eu.int/comm/public_opinion/archives/eb/eb56/eb56_en.pdf

debatit të tanishëm rreth zgjerimit. Është i njohur fakti që publiku i shteteve anëtare të BE-së, megjithëse është deri diku në favor të procesit të zgjerimit, përsëri e pranon se ka probleme në kuptimin e çështjeve kryesore, si dhe që nuk ka informacion të mjaftueshëm rreth asaj se çfarë do të thotë ky proces zgjerimi për ta. Fushata e informimit publik për Euron, me gjithë disa pikëpyetje, përsëri rezultoi një proces i rregullt dhe i organizuar mirë. Zgjerimi, kam përshtypjen, se nuk do të jetë i tillë. Sado liberal që dikush mund të jetë dhe të argumentojë në favor të zgjerimit, ekziston ende një ndjeshmëri negative kundër vendeve ish-komuniste e veçanërisht ndaj atyre të Europës Jug-Lindore. Pa dashur të futemi në çështjet e spastrimit etnik, luftërave civile ose në mosfunksionimin e ligjit dhe të rendit publik dhe polarizimin politik, si dhe shumë probleme të tjera strukturale, këto vende janë zakonisht të shoqëruara me dukuri negative të llojeve të ndryshme. Për njerëzit që konsumojnë shtypin tabloid, çështjet e emigracionit, krimit të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore ose drogave janë çështje që mbahen mend lehtë dhe krijojnë të këta njerëz një perceptim të dyshimtë për realitetin. Për të ardhur keq është fakti që Shqipëria mbart në vetvete shumë nga këto probleme. Pa dashur ta heq vëmendjen nga argumenti kryesor, duke bërë një analizë për dukuri të tilla, ajo çka dua të nxjerr në pah është fakti që procesi i zgjerimit të BE-së ka kërkuar dhe do vazhdojë të kërkojë fushata masive publike, objektivi i të cilave duhet të jetë si publiku evropian po edhe me më shumë rëndësi - publiku shqiptar. Nga një këndvështrim shqiptar vënia e publikut në objektiv do të ndihmonte njerëzit të kuptonin deri në një farë pike çështjet e funksionimit të Bashkimit European, të cilat për fat të keq njihen shumë pak deri më tani. Së dyti, dhe me më shumë rëndësi, kjo strategji do t'i shërbejë një qëllimi politik dhe edukues. Për shembull, referendumet popullore janë një mjet që përdoren shpesh nga vendet europiane për vendosjen mbi çështjet e një sensitiviteti të veçantë. Në këtë dekadë tranzicioni paskomunist, të vetmet referendume që janë mbajtur në Shqipëri kanë pasur të bënin me kushtetutën dhe monarkinë dhe, si rrjedhim, kanë qenë çështje shumë të politizuara në një shoqëri shumë të polarizuar. Referendumet duhet të përdoren në argumente më

substanciale, ashtu siç ndodh kudo. Dhe që njerëzit të kenë mundësi ta shprehin qartë opinionin e tyre, ata duhet të kenë mundësi që të bëjnë një zgjedhje të informuar. Njohuritë për çështjet e Bashkimit Europian do të bëhen shumë të rëndësishme dhe, si pasojë, duhet të jenë të hapura për debat publik.

Është për të ardhur keq që në këtë çast i tërë diskutimi rreth hapjes së negociatave për Marrëveshjen e Asociim-Stabilizimit nuk është aspak vizionar e përqendrohet vetëm në deklaratat klishe për plotësimin e kriterëve politikë. Hapja e negociatave, nëse vërtet ndodh në dhjetor, është thjesht një gjest politik. Ana tjetër e medaljes është kuadri kohor ai që duhet të konsiderohet. Dhe për më tepër, diskutimi nuk duhet të zhvillohet me idenë se çfarë do të përfitojmë ne nga Europa. Vetëm disa ditë më parë një nga shumë gazetave përditshme në vend publikoi një artikull rreth Marrëveshjes së Asociim-Stabilizimit që në mënyrë të çuditshme theksonte pikëpamjen e disa specialistëve, se marrëveshja nuk do të konsistonte në fonde shtesë për Shqipërinë. Kjo logjikë nuk është aspak surprimuese, veçanërisht në një vend me burime të kufizuara financiare dhe ku çdo gjë gjykohet nga një këndvështrim financiar afatshkurtër, me një mungesë të theksuar të një vizioni strategjik. Mbështetja financiare është natyrisht pjesë e paketës së përgjithshme, sidomos kur bëhet fjalë për rajonet vendore ose për probleme të tjera. Megjithatë, kjo nuk do të jetë e lehtë, kur tani më pak se 10 për qind e buxhetit të BE-së po i dedikohet zgjerimit.⁵ Do të ishte gati e pamundur që vendi të përfitojë nga grantet komunitare, veçanërisht kur shtetet anëtare janë duke kundërshtuar një rikonfigurim të sistemit të rregullimit financiar pas zgjerimit. Dhe duke shtuar këtu faktin që ekziston një hapësirë e madhe në terma ekonomikë dhe të të ardhurave midis vendeve anëtare dhe atyre aspirante (nga të gjitha vendet, vetëm Sllovenia ka një standard që mund t' i afrohet vendeve të BE), atëherë pjesa e mbështetjes ekonomike, që vendet do të hyjnë në BE mund të shpresojnë, është e pakonsiderueshme. Ajo që dua të nënvizohet këtu është ideja se paraja nuk duhet të jetë motivi kryesor për rrugën drejt Bashkimit

⁵ The Guardian, *Bigger is Beautiful*, Heather Grabbe, July 13, 2001.

European. Ajo, që vërtetë duhet të ushqejë forcën kryesore drejt Europës, duhet të jetë kërkimi i stabilitetit, sigurisë dhe prosperitetit ekonomik nëpërmjet tregtisë së lirë dhe investimeve.

Ajo çka unë shikoj tek anëtarësia në BE, nëse vërtetë do të ndodhë në një pikë të caktuar, është akti final i vlerësimit se ky vend është një pjesë integrale politike, ekonomike dhe sociale dhe jo vetëm fizike e Europës. Në vijim të përpjekjeve shekullore për ta identifikuar vetveten pas ndarjes fetare të lindjes me perëndimin, regjimit otoman, prapambetjes komuniste dhe pas një dekade të një demokracie të lëkundur, por e orientuar gjithmonë përpara - që në kompleks e kanë lënë vendin në një mënyrë ose tjetër jashtë kufijve politikë të Europës, anëtarësimi në BE do të ishte akti i fundëm i kompletimit të vetëkonfidencës sonë. Megjithatë, pa dashur të tingëlloj skeptik më shumë seç duhet, përpara është një rrugë e gjatë dhe statusi aktual i gjërave nuk është shumë nxitës. Sidoqoftë, kjo nuk duhet të na ndalojë të fillojmë të përgatitemi dhe të punojmë për një kuptim më të mirë të funksionimit të Bashkimit European, në mënyrë që njerëzit të dijnë se çfarë të presin prej tij, në mënyrë që ta shfrytëzojnë atë sa më mirë.

Referencat:

Dinan Desmond, *Ever Closer Union*, (Macmillan Press, London 1994)

Hyde-Price Adrian, *International Politics of Eastern Europe* (Manchester University Press, Manchester 1996)

Nugent Niell, *The Government and Politics of the European Union Third Edition* (Macmillan Press, London, London 1994)

World Affairs Online www.heldref.org

Political Science Quarterly Online www.psqonline.org

European Union Online www.europa.eu.int

Centre for European Reform www.cer.org

BBC Online www.bbc.co.uk

Korrieri Online www.korrieri.com

Ballkan Online www.ballkan.com

The Guardian Online www.guardian.co.uk

The Times Online www.thetimes.co.uk

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Filip Lako
Jurist

Ligji nr. 8806, datë 17.5.2001 “Për disa shtesa në ligjin nr.8563, datë 22.12.1999 “Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të Bankës së Kursimeve sh.a.”” Në nenin 1 të ligjit nr.8563, datë 22.12.1999 thuhet: “Forma e privatizimit të Bankës së Kursimeve sh.a. do të jetë ajo e transferimit të së drejtës së pronësisë 100 për qind të aksioneve të saj të tretëve, nëpërmjet shitjes, sipas formulës së privatizimit të parashikuar në këtë ligj.” Me ligjin nr.8806, datë 17.5.2001 bëhen dy shtesa në ligjin nr.8563, datë 22.12.1999. Konkretisht në nenin 1, që cituam më lart, pas fjalëve “nëpërmjet shitjes” shtohen fjalët “ose shitjes me kusht”. Gjithashtu, nenit 1 i shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Në rast se marrëveshja për transferimin e së drejtës së pronësisë të aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a. do të bëhet me kushte, kjo marrëveshje duhet të miratohet nga Kuvendi.” Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.6.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.31 të vitit 2001, faqe 965.

Ligji nr.8807, datë 17.5.2001 “Për një ndryshim në ligjin nr.8437, datë 28.12.1998 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr.8507, datë 19.7.1999, nr.8595, datë 6.4.2000 dhe nr. 8716, datë 15.12.2000”. Ligji bazë, pra ligji nr.8437, datë 28.12.1999 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” ka pësuar disa ndryshime me 3 ligjet që përmendëm në titull. Ligji i tanishëm, pra ligji nr.8807, datë 17.5.2001 ndryshon

dhe shton në nenin 3, i cili ka pësuar shumë ndryshime me ligjin nr.8507, datë 7.7.1999. Kështu, është shtuar në nenin 3 nëndarja 9, gërma “DH” për nënproduktet e naftës, ku bashkë me bitumin, tolnolin, silolin, sqfurin dhe solventin ishin dhe koksi i naftës. Ligji nr.8807, datë 17.5.2001 i heq nga gërma “DH” e nëndarjes 9 të nenit 3 fjalët “koks nafte” dhe i vendos në shtesën që bëhet, pra, në nëndarjen 9/1, duke shtuar në këtë nëndarje fjalët: Koks nafte - 5 për qind”. Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.6.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.31 të vitit 2001, faqe 965.

Ligj nr.8808, datë 17.5.2001 “Për një ndryshim në ligjin nr.8474, datë 14.4.1999 “Për miratimin e nomenklaturës dhe të tarifës doganore”, ndryshuar me ligjet nr.8558, datë 22.12.1999 dhe nr.8712, datë 15.2.2000”. Me ligjin nr.8474, datë 14.4.1999 është miratuar nomenklatura dhe tarifa doganore, por kjo nomenklaturë dhe tarifë doganore është botuar nga Ministria e Financave dhe gjendet si botim i veçantë, edhe pse ligji përmend se ajo i bashkëlidhet atij. Me ligjin nr.8808, datë 17.5.2001 bëhet ndryshimi i tretë i disa prej tarifave doganore. Kështu, në krerët 27131100 dhe 27131200, tarifa doganore prej 15 për qind ndryshohet dhe zëvendësohet me tarifën 2 për qind. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.6.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.31 të vitit 2001, faqe 966.

Ligji nr.8809, datë 17.5.2001 “Për një ndryshim në ligjin nr.8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”. Në ligjin nr.8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve” thuhet se për nxitjen, zhvillimin dhe garancinë e prodhimit, të përpunimit dhe të tregtimit të duhanit dhe të produkteve të tij, krijohet Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve, e cila është institucion shtetëror me statusin e personit juridik, pa qëllim fitimi, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë.”Për zbatimin e detyrave dhe të funksioneve që ka Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve krijohet “Fondi i Duhanit” i cili administrohet

nga kjo Agjenci. Në pikën 3 të nenit 21 të ligjit nr.8691, datë 16.11.2000 thuhet: “Mjetet e “Fondit të Duhanit” krijohen nga këto burime: 2 për qind e të ardhurave të realizuara nga shitja e duhanit të fermentuar, si dhe 2 për qind nga të ardhurat e realizuara nga shitja e produkteve të duhanit. Këto kuota janë të detyrueshme për t’u paguar nga çdo person fizik dhe juridik, përpunues dhe importues dhe kalojnë në ngarkim të kostos.” Me ligjin nr.8809, datë 17.5.2001, gërma “a” e pikës 3 të nenit 21 të ligjit nr.8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve” shfuqizohet. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi në 24.6.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.31 të vitit 2001, faqe 967.

Ligji nr.8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës të privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelecom””. Sipas ligjit të lartpërmendur, shoqëria anonime “Albtelecom” i nënshtrohet privatizimit, i cili do të realizohet nëpërmjet transferimit të së drejtës së pronësisë të 100 për qind të aksioneve të zotëruara nga shteti të tretëve, sipas formulës së privatizimit që parashikohet në këtë ligj. Forma dhe formula e privatizimit të aksioneve të “Albtelecom”-it parashikon që jo më pak se 51 për qind, por jo më shumë se 76 për qind e aksioneve të kapitalit, u ofrohen investitorëve strategjikë të cilët janë shoqëri të specializuara në fushën e telekomunikacioneve. Paketa e aksioneve të parashikuara, siç u tha më lart, do të transferohet nëpërmjet shitjes me tender të hapur ndërkombëtar dhe paguhet me USD. Madhësia e kësaj pakete përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Paketa e mbetur e aksioneve të kapitalit u ofrohet ish-pronarëve të mëparshëm të truallit dhe të ndërtesave, si dhe punonjësve të “Albtelecom” sh.a. Këtu përfshihen punonjësit aktualë dhe ata të trajtuar me asistencë një vit para publikimit të shoqërisë për privatizim. Ligji zgjidh edhe problemin e trajtimit të punonjësve që do të dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit në kuadrin e privatizimit, mënyrën e përdorimit të të ardhurave nga privatizimi etj. Kriteret e përzgjedhjes së investitorëve

strategjikë dhe kriteret e vlerësimit të ofertave për privatizim do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ligji ka 7 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.6.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.31 të vitit 2001, faqe 967.

Ligji nr.8812, datë 17.5.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”.Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë i miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.3.1996, ka hyrë në fuqi më 1.6.1996. Qysh nga koha e hyrjes në fuqi e deri sot ky kod ka pësuar pesë herë ndryshime, shtesa e shfuqizime nenesh, paragrafësh etj. Me ligjin e lartpërmendur bëhen 58 ndryshime, 30 shtesa, 26 shfuqizime, si dhe disa ndryshime titujsh e zëvendësime. Ndryshime, shtesa e shfuqizime gjen gati në të katër pjesët e Kodit dhe në veçanti në titujt dhe krenat. Më poshtë po vëmë në dukje se ku ka më shumë ndryshime, shtesa e shfuqizime. Kështu, ndryshime ka në Titullin III, Kreu I, në Kreun VI që ka të bëjë me sekretarinë gjyqësore, në Titullin V Kreu V lidhur me mjetet ligjore të mbrojtjes etj. Gjykimi në shkallën e parë përfshihet në pjesën e dytë dhe kjo pjesë ka disa shtesa e shfuqizime me rëndësi për shtesa e përket ngritjes së padisë, drejtimit të procesit, veprimet përgatitore etj. Ndryshimet më të mëdha i gjen në Titullin IV në Kreun I, II, III, IV e VI. Në pjesën e tretë, ku flitet për mjetet ligjore të mbrojtjes ka ndryshime të rëndësishme. Kështu, kërkesa për rishikimin e vendimeve nuk paraqitet më në gjykatën që ka dhënë vendimin, po në Gjykatën e Lartë. Po ashtu, shfuqizohet instituti i kundërshtimit të të tretit (nenet 503, 504, 505, 506, 507, 508 dhe 509). E rëndësishme është të vihet në dukje edhe shfuqizimi i nenit 473 që ka të bëjë me rekursin në interes të ligjit, si dhe rregullimet që janë bërë për shqyrtimin në kolegjet e bashkuara. Interes paraqesin ndryshimet e shfuqizimet në dispozitat lidhur me ekzekutimin e detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore dhe mbi shumat e llogarive bankare. Për të lehtësuar ndjekjen e ndryshimeve po renditim

kronologjikisht ligjet që kanë bërë këto ndryshime: ligji nr.8181, datë 23.11.1996, ligji nr.8431, datë 14.12.1998, ligji nr. 8491, datë 27.5.1999, ligji nr.8535, datë 18.10.1999 dhe ligji nr.8601, datë 10.4.2000. Ligji nr. 8812, datë 17.5.2001 ka 128 nene dhe ka hyrë në fuqi më 27.6.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.32 të vitit 2001.

Ligj nr.8814, datë 20.9.2001 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.6, datë 3.9.2001 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr.8718, datë 19.12.2000 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001””. Me aktin normativ, me fuqinë e ligjit, nr.6, datë 3.9.2001, siç përmendet edhe në titull, bëhen ndryshime në ligjin për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001. Kështu, në nenin 1 të ligjit “Për Buxhetin”, ku flitet për “Fondin e konsoliduar për vitin 2001” shtohen të ardhurat nga Buxheti i Shtetit, si dhe shpenzimet e Buxhetit të Shtetit. Po në nenin 1, ndryshime ka në të ardhurat e shpenzimet e Buxhetit Qendror e të Buxhetit të pavarur të pushtetit vendor. Në nenin 2, ku flitet për Buxhetin e Sigurimeve Shoqërore për vitin 2001, ka shtesa në të ardhurat, të cilave u shtohen edhe tepricat e fondit të vitit 2000. Në Kreun II “Burimet për mbështetjen e shpenzimeve buxhetore”, në nenin 4, akti normativ bën shtesa të ndryshme, në krahasim me ligjin, përsa i përket të ardhurave jotatimore. Ndryshime bëhen edhe përsa i përket shpenzimeve korente, shpenzimeve kapitale, rezervave të Këshillit të Ministrave etj. në nenin 7 që parashikohen në kreun III “Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit”. Në këtë kre ndryshime ka edhe në nenet 9, 10 dhe 15. Akti normativ nr.6, datë 3.9.2001 është miratuar me ligjin nr.8814, datë 29.9.2001, i cili ka hyrë në fuqi më 4.11.2001 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr.47 të vitit 2001, faqe 1475.

Ligji nr.8815, datë 20.9.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës Italiane, lidhur me

veprimtarinë e bashkëpunimit dhe të asistencës për ristrukturimin e infrastrukturave logjistike dhe stërvitore në Akademinë e Forcave Ajrore në Vlorë dhe për risistemimin e pistës së fluturimit prej dheu në Pishë-Poro’”. Marrëveshja e lartpërmendur midis Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës Italiane ka në bazë të saj marrëveshjen e NATO (SOFA) Pfp, ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr.8304. Midis të dy vendeve është lidhur edhe Marrëveshja për Bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, e cila është firmosur në Romë më datën 13.10.1995. Ajo është ratifikuar nga Parlamenti Italian me ligjin nr.49, datë 18 shkurt 1999 dhe nga Kuvendi me ligjin nr.8128, datë 22.7.1996. Këto Marrëveshje, si dhe disa akte ligjore e nënligjore të të dy vendeve, janë baza e Marrëveshjes të miratuar me ligjin nr.8815, datë 20.9.2001. Këtu parashikohen edhe detyrimet e të dy palëve, si dhe probleme të ndërhyrjeve të programuara për zonën logjistike të Akademisë së Forcave Ajrore, ndërhyrjet e Programuara në Zonën Operative të Pishë-Poros, përbërja dhe detyrat e Njësisë Logjistike të Aviacionit Ushtarak Italian dhe grupet e parashikuara të punës. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 3.11.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.47 të vitit 2001, faqe 1475. Ligjit i bashkëlidhet edhe Marrëveshja.

Ligj nr.8816, datë 20.9.2001 “Për ratifikimin e “Protokollit të tretë shtesë të “Marrëveshjes së Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse të Europës Juglindore””. Marrëveshja e Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse e Europës Juglindore është nënshkruar në Shkup më 26 shtator 1998. Protokollin subjekt ratifikimi, pra “Protokollin i tretë shtesë i “Marrëveshjes së Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse të Europës Juglindore”” është nënshkruar në Athinë më 21 qershor 2002. Ndërmjet çështjeve që rregullon ky protokoll, rëndësi paraqet përcaktimi i Statutit të Përshtatshëm të Shtabit të SEEBRIG (Shtabi i Forcës) të vendosur përkohësisht ose mbi bazën e rotacionit, në territoret e tyre, në përputhje me

Marrëveshjen e Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse të Europës Juglindore, si dhe personalitetit të tij e familjeve të tyre. Sipas Protokollit, Shtabi i Forcës gëzon personalitet juridik, çlirohet nga shërbimet e taksat dhe ka favore për të shfrytëzuar pa pagesë çdo truall, ndërtesë ose instalime të caktuara për shtabin e SEERBRIG-ut (Shtabin e forcës). Protokollin rregullon edhe probleme të buxhetit, të arkivave e dokumenteve zyrtare të Shtabit të Forcës etj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 3.11.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.47 të vitit 2001, në faqen 1483. Ligjit i bashkëlidhet edhe Protokollin i Tretë Shtesë i Marrëveshjes së Forcës Shumëkombëshe të Europës Juglindore.

Ligji nr.8817, datë 27.9.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Bashkëpunimit Tregtar dhe Ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit Izraelit””. Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shtetit të Izraelit, duke dashur të zhvillojnë marrëdhëniet tregtare dhe ekonomike ndërmjet të dy vendeve mbi bazën e barazisë dhe të përfitimit të ndërsjellë dhe për të krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e kontakteve ndërmjet njësive ekonomike të të dy vendeve, si dhe për nxitjen e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik në fusha me interes të ndërsjellë, lidhën Marrëveshjen e cila është ratifikuar me ligjin e lartpërmendur. Marrëdhëniet tregtare midis dy vendeve do të zhvillohen në përputhje me parimet bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT 1994) dhe Marrëveshjes Themelore për Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT). Pra, objekt i kësaj Marrëveshjeje është të përcaktojë parimet, rregullat dhe disiplinat për udhëheqjen e marrëdhënieve të ndërsjella tregtare dhe ekonomike ndërmjet palëve, të cilët marrin përsipër, që nën kornizën e legjislacionit të tyre kombëtar dhe detyrimeve ndërkombëtare, të nxisin dhe harmonizojnë zhvillimin tregtar dypalësh, si dhe forma të ndryshme të bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik. Në marrëveshje trajtohen edhe probleme të kombit më të favorizuar, të

mosdiskriminimit, të masave antidumping, balancuese etj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 3.11.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.47 të vitit 2001, faqe 1486. Ligji i bashkëlidhet edhe Marrëveshja.

Ligji nr.8818, datë 27.9.2001 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për krijimin e Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore””. Organizata ndërkombëtare e Metrologjisë Ligjore është krijuar me dëshirën e disa shteteve palë në këtë Konventë, me dëshirën për të zgjidhur në nivel ndërkombëtar problemet teknike dhe administrative që kanë dalë nga përdorimi i instrumenteve matëse. Organizata Ndërkombëtare e Metrologjisë Ligjore ka krijuar një qendër dokumentacioni dhe informacioni dhe kryen studime me synim unifikimin e metodave dhe rregulloreve, si dhe për problemet me karakter legjislativ dhe rregullator, zgjidhja e të cilave është me interes ndërkombëtar. Në Konventë gjen shprehje të plotë qëllimi dhe ndërtimi i organizatës, si dhe jepen shpjegime se çfarë është Konferenca Ndërkombëtare për Metrologjinë Ligjore dhe cili është qëllimi i konferencës, nga kush përbëhet Komisioni Ndërkombëtar i Metrologjisë Ligjore dhe cilat janë detyrat e këtij Komisioni etj. Në fund Konventa flet për klauzolat financiare si për shembull shpenzimet për veprimtarinë e Organizatës, nga cilët mbulohen këto shpenzime, kontributet dhe detyrimet financiare të shteteve anëtare etj. Për vendin tonë detyrimet financiare, që rrjedhin nga ky anëtarësim, do të përballohen nga Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe Kalibrimit. Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 3.11.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.47 të vitit 2001, faqe 1492. Ligji i bashkëlidhet edhe Konventa.

Ligj nr.8819, datë 27.9.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Kuvaitjan “Për zhvillimin ekonomik arab” për projektin e dytë të rehabilitimit të ujitjes””. Më datën 5.2.2001 është lidhur një marrëveshje huaje midis

Republikës së Shqipërisë si huamarrëse, e përfaqësuar nga Qeveria e Shqipërisë dhe Fondit Kuvaitjan për Zhvillimin Ekonomik Arab. Qëllimi i Fondit Kuvaitjan është të ndihmojë vendet arabe dhe vendet e tjera në zhvillim për zhvillimin e ekonomisë së tyre, dhe t'u sigurojë atyre huatë e nevojshme për kryerjen e projekteve e të programeve të tyre të zhvillimit. Marrëveshja parashikon masën e huasë, masën dhe pagimin e interesave e të detyrimeve të tjera, vendin e pagesës, sigurimin e parave, tërheqjen dhe përdorimin e huasë, mënyrën e lidhjes të marrëveshjeve të veçanta midis palëve. Gjithashtu, parashikohen detyrimet e Marrëveshjes, pushimi i ushtrimit të të drejtave, arbitrazhi, datat efektive të përfundimit etj. Marrëveshjes i lidhet lista nr.1 që ka të bëjë me klauzolat e shlyerjes dhe lista nr.2 ku bëhet përshkrimi i projektit. Pas listave gjendet letra nr.1 e cila përmban listën e mallrave, procedurat për prokurimin. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 11.11.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.48 të vitit 2001, faqe 1515. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja e Huasë (Projekti i dytë i rehabilitimit të ujitjes – faza II).

Ligji nr.8820, datë 27.9.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e “Shpërndarja e Shërbimeve Sociale””. Marrëveshja e lartpërmendur është lidhur më 3 korrik 2001. Huamarrësi (Republika e Shqipërisë) dhe Shoqata (Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim) kanë rënë dakord që Huamarrësi të marrë financime grant nga Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar i Britanisë së Madhe për shumën dy milionë e pesëqind mijë dollarë për të financuar projektin. Marrëveshja parashikon kushtet e përgjithshme dhe përkufizimet, zbatimin e projektit dhe klauzolat financiare, mjetet ligjore të shoqatës, datën e hyrjes në fuqi dhe përfundimin, si dhe përfaqësuesin e Huamarrësit. Pas Marrëveshjes gjendet Skeduli 1 Aneksi A ku përshkruhen tërheqjet e kredisë, Skeduli 1 Aneksi B që rregullon veprimet me llogarinë e posaçme kur tërheqjet bëhen në bazë të Raporteve të

Menaxhimit të Projektit, Skeduli 2 për përshkrimin e projektit, Skeduli 3 për prokurimet dhe shërbimet e konsulencës, skeduli 4 për programin e zbatimit dhe skeduli 5 për procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e nënprojekteve. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 11.11.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.48 të vitit 2001, në faqen 1527. Ligji i bashkëlidhet Marrëveshja dhe skedulet.

Ligji nr.8821, datë 15.10.2001 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën Ndërkombëtare të Eurocontrol-it””. Konventa e lartpërmendur është miratuar më 13.12.1960 dhe titullohet “Konventa Ndërkombëtare e EUROCONTROL-it për bashkëpunimin për sigurinë e navigimit ajror”. Kjo Konventë është amenduar nga Protokollin shtesë, i nënshkruar në Bruksel më 6.7.1970, i cili është amenduar nga Protokollin i datës 21.11.1978. Të gjitha këto janë amenduar nga Protokollin i nënshkruar në Bruksel më 12.2.1981. Republika e Shqipërisë, përveç aderimit në “Konventën Ndërkombëtare Eurocontrol”, me ligjin e lartpërmendur ka aderuar edhe në “Marrëveshjen shumëpalëshe për pagesat e rrugës” të 12 shkurtit 1981 dhe në Protokollin që konsolidon “Konventën Ndërkombëtare të Eurocontrol-it” dhe amendamentet e saj, hapur për nënshkrim në Bruksel më 27 qershor 1997. Ligji ka 4 nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.11.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.48 të vitit 2001, faqe 1542.

Ligji nr.8822, datë 15.10.2001 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.5, datë 31.8.2001 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në ligjin nr.8668, datë 23.10.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”. Me ligjin nr.8668, datë 23.10.2000 bëhet një rregullim më i plotë e më i saktë lidhur me pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit. Neni 3 i këtij ligji përcakton se shtetasit shqiptarë me pasaportë të vlefshme për 5 vjet, ndërsa ata mbi 16 vjeç pajisen me pasaportë të vlefshme për 10 vjet. Me ligjin

nr.8668, datë 23.10.2000 shfuqizohej dekreti nr.7393, datë 12.6.1990 “Për lëshimin e pasaportave dhe dhënien e vizave”. Ky ligj ka hyrë në fuqi më 22.12.2000. Akti normativ me fuqinë e ligjit nr.5, datë 31.8.2001 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8668, datë 23.10.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, pas nenit 14 shton nenin 14/1 dhe urdhëron që neni 3 i ligjit nr.8668, datë 23.10.2000 (pra, ai nen që udhëzonte pajisjen edhe të shtetasve shqiptarë me moshë deri 16 vjec me pasaportë) do të zbatohet pas datës 30.6.2002 dhe deri në këtë datë do të zbatohen paragrafet 2 e 4 të nenit 2 dhe neni 14 i dekretit nr.7393, datë 12.6.1990 “Për lëshimin e pasaportave për jashtë shtetit dhe dhënien e vizave. (Pra, të atij dekreti që ishte shfuqizuar me ligjin nr.8668, datë 23.10.2000). Gjithashtu, me aktin normativ nr.5, datë 31.8.2001, në fund të nenit 15 të ligjit nr.8668, datë 23.10.2000 shtohen fjalët: “duke mbetur në fuqi përkohësisht dispozitat e përcaktuara në nenin 14/1 të këtij ligji.” Akti normativ është miratuar me ligjin nr.8822, datë 15.10.2001, i cili ka 1 nen dhe ka hyrë në fuqi më 10.11.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.48, të vitit 2001, faqe 1543.

Ligji nr.8823, datë 18.10.2001 “Për buxhetin faktik të vitit 2000”.

Buxheti faktik i vitit 2000 tregohet në mënyrë analitike në ligjin e lartpërmendur. Sipas pasqyrës, të ardhurat e Buxhetit të Shtetit kanë qënë 100.584 milionë lekë dhe shpenzimet 150.021 milionë lekë. Një përafrim midis të ardhurave e shpenzimeve ka në buxhetin e sigurimeve shoqërore. Kështu, të ardhurat kanë qënë 28.012 milionë lekë dhe shpenzimet 28.948 milionë lekë. Të ardhurat kanë qënë më shumë se sa shpenzimet në buxhetin e sigurimeve shëndetësore në masën: 2816 milionë lekë të ardhurat dhe 2427 milionë lekë shpenzimet. Por në total deficitit buxhetor ka qënë 49.984 milionë lekë. Ky deficit do të ketë financim të brendshëm, kredi nga Banka e Shqipërisë, bono thesari, të ardhura nga privatizimi, financim të huaj etj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.11.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.48 të vitit 2001, faqe 1543.

Ligji nr.8824, datë 5.11.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së riskedulimit të borxhit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë””. Në këtë Marrëveshje Riskedulimi Qeveria e Republikës së Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave të Shqipërisë dhe Banka Qendrore e Republikës së Turqisë bien dakord që të riskedulojnë borxhin që rrjedh nga Marrëveshja Ndërbankare e datës 20 shkurt 1987 ndërmjet Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë dhe Bankës së Shtetit të Shqipërisë. Në këtë Marrëveshje Riskedulimi, bëhet fjalë për pagimin e principalit prej 3.413.872.43 USD dhe interesit të akumuluar deri më 31 mars 2001 që është 1.713.308.31 USD. Shuma e principalit dhe interesi i akumuluar prej 5.127.180.74 USD do të paguhen në një periudhë prej pesëmbëdhjetë vjetësh, përfshirë pesë vjet garancie. Banka Qendrore e Republikës së Turqisë ka rënë dakord të falë shumën e interes-vonesave prej 456.647.50 USD. Në Marrëveshje përcaktohen periudhat e pagesave, vendi se ku do të depozitohen pagesat, llogaritja e interesave për “Llogarinë e riskedulimit”, mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve etj. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.12.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.53 të vitit 2001, faqe 1685. Ligjit i bashkëlidhet edhe Marrëveshja.

Ligji nr.8825, datë 5.11.2001 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7664, datë 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit””. Me ligjin e lartpërmendur, ndryshimi i parë që i bëhet ligjit nr.7664, datë 21.1.1993 ka të bëjë me disa emërtime. Kështu, kudo në ligj, emërtimi “Agjencia Kombëtare e Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “Ministria e Mjedisit” dhe emërtimi “Kryetar i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “Ministër i Mjedisit”. Ndryshimi i dytë bëhet në nenin 41, ku fjalia e fundit e paragrafit të parë të nenit 41 ndryshohet, duke saktësuar se Ministri cakton Kryeinspektorin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Mjedisit. Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.12.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.53 të vitit 2001, në faqen 1688.

Ligji nr.8826, datë 5.11.2001 “Për disa shtesa në ligjin nr.7564, datë 19.5.1992 “Për të drejtën e autorit””. Ligjit nr.7564, datë 19.5.1992 “Për të drejtën e autorit” i janë bërë disa shtesa e ndryshime me ligjet nr.7923, datë 19.4.1995, nr.8594, datë 6.4.2000 dhe nr.8630, datë 3.7.2000. Me ligjin nr.8826, datë 5.11.2001 bëhen disa shtesa në kreun 9 të ligjit bazë nr.7564, 19.5.1992 ku flitet për masat dhe sanksionet në rast shkeljesh të të drejtave të përcaktuara në këtë ligj. Në këtë kre shtohen 4 nene. Kështu, neni 50/1 saktëson se përdorimi i pronësisë artistike, nga subjektet fizike dhe juridike pa lejen e autorit, si dhe mospagimi në afat i detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kontratave me përdoruesit e pronësisë artistike, përbën kundërvajtje administrative. Në nenin 50/2 cakton masën e gjobës për këto shkelje, si dhe rendit se cilët do të quhen përdorues për efekt të zbatimit të kondravajtjes. Sipas nenit 50/3 gjobat e vjelura nga përdoruesit e pronësisë artistike, në kundërshtim me ligjin, kalojnë 60 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe 40 për qind në llogari të shoqërive të autorëve. Neni 50/4 ngarkon Ministrinë e Financave të nxjerrë udhëzim për mënyrën e kontrollit të përdoruesve të pronësisë intelektuale nga organet e Policisë Tatimore. Ligji ka 5 nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.12.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.53 të vitit 2001, në faqen 1689.

Ligji nr.8827, datë 5.11.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për transportin ndërkombëtar rrugor””. Marrëveshja e ratifikuar me ligjin e lartpërmendur do të zbatohet në transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave ndërmjet dy palëve kontraktuese në tranzitin e dy territoreve përkatëse dhe në udhëtimin e mjeteve pa ngarkesë në lidhje me transportin e sipërpërmendur. Marrëveshja jep sqarime të plota për përkufizimet që ajo përmban, për transportin e udhëtarëve e të mallrave, për hyrjen në treg, për siguracionin, kabotazhin, doganat e kontrollin shëndetësor, kontrollin teknik të mjeteve etj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në

fuqi më 12.12.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.54 të vitit 2001, faqe 1697. Marrëveshja që i bashkëlidhet këtij ligji gjendet e botuar në Fletoren Zyrtare nr.54/1 të vitit 2001, faqe 1.

A few reflections on the european integration

Eno Ngjela

Earlier this month the EU announced its plans towards enlargement by including the first wave of the countries of Eastern and Central Europe to join the union at the beginning of 2004. Despite the fact that this is quite an event with a great impact upon the political, economic and social developments of the current and future members of the union there is room for reflection and considerations to be contemplated. The political will towards the enlargement is proving to be a strong token of commitment towards sharing the values of democracy and free market by institutionalizing the common efforts of the European countries in a joint pathway to the future.

Whereas, the countries that were offered the chance to join the union have all the right to be enthusiastic about this achievement which they have been working towards for the past decade, the rest of the countries where Albania is part of have also all the right to feel that they are lagging behind. This is not the point and there is scarce room for argument since there is no one to be blamed apart from the Albanian related factors. Where there is room for argument is the fact that how will this “Golden Curtain”¹ that is currently being enforced in Europe influence the second wave of the greater

¹ Defining the borders of the new Europe, World Affairs, Spring 2002 (www.heldref.org)

enlargement. There are issues that are not being said just for the sake of being politically correct but they are indeed all factors that one can easily speculate in drawing not quite optimistic conclusions. There are political, economical, historical, religious and societal elements that do not favor Albania amongst others in Southern Eastern Europe to qualify as a candidate country worth of betting money on a non-distant EU. Nonetheless, it may not help at this particular point to engage in an analysis, which will not be particularly useful in generating commitment towards integration.

What I would like to emphasize in this paper is the necessity for an institutional and public debate to promote a better understanding of the integration process in order to create a healthy foundation that will enable the state and non-state actors to be fully geared towards this ultimate goal. It is not too early to start thinking and to comprehend the first wave of enlargement in order to get prepared when the time will come for Albania. It would be useful to start to consider the institutional background of the country vis a vis the future EU membership. What are our problems in terms of institutional approach, settings and efficiency that need to be pointed out and addressed in order to facilitate a smooth entry to the EU?

To engage properly into the argument, what need to be done is a desktop review of the Albanian institutions and how geared up are they to be functionally ready to join the union. However, this needs quite an in-depth analysis. For the purpose of this paper I would like to contemplate briefly the parliament since it is one of the main institutions whose progress will be assessed in the Democracy and Rule of Law pillar.² Despite being now a relatively aged state with some experience in institutional building, (not necessarily a good one but nonetheless something that counts) Albania offers a feeble background in parliamentary affairs where the clan influences have shown to be predominant over ideological inclinations as it is usually the

² Commission of European Communities, Commission Staff Working Paper, "Albania Stability and Association Report" (Brussels, 5 April 2002).

case elsewhere. The post-communist parliaments of Albania reflects at large a national assembly where the divisions of seats has little to do with principles and policies and this is due to the fact that the political spectrum is hardly divided on clear cut ideological stances. This is pretty much the case to a certain extent in all the former communist countries of Eastern Europe where the political parties do not generally reflect the traditional divisions that we are used to consider in term of conservative or left wing parties. This argument is particularly relevant in Albania where the division of the main parties in terms of ideological principles and attitudes is blurry to say the least. From the commitment towards the integration viewpoint this is more than optimal since there are no arguments regarding the aspirations to join NATO and the EU. However from the strategic point of view, a deeper look will discover a very ad-hoc structure where the back-bench MPs (and not only) have little or nothing to offer to any substantial debate on integration and let alone to be able to generate any long term approaches to achieve this aim.

It would have been normal and appropriate that by now discussions regarding the issues of legislative standardization and what impact will it have on the standard procedures of the parliamentary work to have at least started. There will be a not so distant need to create a Commission of Legislation and European Law following other accession countries' experiences which will ensure the compatibility of law-making processes. Or more importantly, perhaps to deal with issues of the sliced sovereignty or the pooled one as it is usually referred in the EU. This is particularly relevant for the small states where the impact of such a consequence will be of a greater magnitude. According to Joseph Frankel, nowadays all states are facing a diminution of their sovereignty.³ We might be eager to join the club, but we must also be

³ Quoted at Hyde-Price Adrian, "The International Politics of East and Central Europe" (Manchester University Press, Manchester, 1996) p. 287.

